



Tutu dhe Elefantushi kërkojnë fëmijët



Save the Children



**AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO**

Autorët:

Adelina Mamaqi, Rovena Rrozhani, Muzafer Çaushti

Ilustrimet:

Shirli Përmeti, Ledia Kostandini

Korrektore letrare:

Viola Grillo

Grupi i ekspertëve:

Anila Sulstarova, Blerta Bodinaku.

Konsulentë:

Irida Agolli, Stela Dhima, Aurora Guxholli, Ardita Kovaçi, Elvira Sokoli,
Irena Shtraza, Anxhela Gramo, Izela Tahsini.

Koordinatorë e grupit të punës:

Dhurata Nixha

Ky publikim u mundësua në kuadër të projektit “Drejt një Arsimit Gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët 0-6 vjeç në Shqipëri” i mbështetur nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim dhe Save the Children, si dhe i zbatuar në partneritet me shoqatën MEDPAK dhe Universitetin e Bolonjës.

Ky libër me përralla dhe tregime, për fëmijët e moshës parashkollore, është një ripunim i botimeve “Kush e shëroj Elfantushin” dhe “Tutuja mëson të dëgjojë” ribotimi i të cilëve u realizua me lejen e Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Shëndetit Mendor. Ky botim sjell edhe tre tregime të reja që trajtojnë çështje të lidhura me tërmetin dhe pandeminë.

© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej specialistëve të fushës, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim të shoqërohet me njohjen e autorëve përkatës si dhe Save the Children dhe Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Shëndetit Mendor, si burim. Këndvështrimet e autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjet e Save the Children.

Shumë prej nesh, ende kanë të ngulitur në mendje që nga fëmijëria përrallën e vet të preferuar, së bashku me zërin e mamit, apo gjyshes dhe imazhet e fytyrës së tyre, dhomës, dritës, pyetjet dhe përgjigjet. Nuk është aspak çudi, që ashtu në heshtje, larg vështrimit dhe vëmendjes sonë, këto përralla të vazhdojnë të na shoqërojnë në të përditshmen, përmes ndjesive që na zgjojnë, mënyrës se si kuptojmë, si ndiejmë, apo edhe mënyrës si jetojmë.

Nuk e ekzagjerojmë aspak nëse u japim kaq shumë vlerë përrallave. Në të vërtetë, përveçse një mjet argëtues, përrallat, mbi të gjitha, ofrojnë rrugë të çmuara përmes të cilave fëmijët fillojnë të mësojnë për botën, për të tjerët, për veten, për marrëdhëniet, vlerat, apo të tjera koncepte të rëndësishme jetësore. Janë këto mësimet të hershme për të mirën dhe të keqen, të drejtën dhe të gabuarën, të bukurën e të shëmtuarën, që i mësojmë herët e na shoqërojnë gjatë gjithë jetës.

Është detyra e prindërve, edukatorëve, mësuesve dhe të rriturve të tjerë përreth të asistojnë fëmijët në këtë udhëtim të gjatë mësimi dhe njohjeje. E bashkë me fëmijën, këtë udhëtim e ndërmarrin edhe të rriturit që i shoqërojnë fëmijët në këtë proces. Ata përballen me sfidat e fëmijës për të ndërtuar imazhin e botës rreth tij, por edhe me sfidat personale për t'u prezantuar fëmijëve çështje, të cilat mund të jenë të vështira edhe për vetë të rriturit.

Çështje të tilla, si: sëmundja, humbja, ndarja, vdekja, zemërimi, ankthi, dallimet gjinore, të kërkuarit ndihmë, të thënit “jo”, marrja e përgjegjësive, ballafaqimi me

fatëkeqësitë natyrore, etj. shpesh herë përbëjnë sfidë edhe për vetë të rriturit, të cilët gjenden përballë dilemës si të japin mesazhet e duhura në mënyrën e duhur.

Ky libër është ideuar dhe hartuar në mënyrë të tillë që të jetë mbështetje për prindërit dhe edukatorët në adresimin e këtyre çështjeve në mënyrë të thjeshtë dhe të efektshme, duke i ndihmuar fëmijët të ndërtojnë vlera të sigurta dhe të shëndetshme që do t'i shoqërojnë gjatë jetës.

Libri është punuar me shumë dashuri dhe profesionalizëm nga një ekip me eksperiencë shkrimtarësh, ilustruesish dhe profesionistësh të zhvillimit të fëmijëve dhe mund të shërbejë edhe si model në punën tuaj, për të adresuar jo vetëm çështjet që paraqiten në të, por çfarëdolloj çështjeje që do të paraqesë rëndësi dhe sfidë në rrugën e rritjes së fëmijëve.

Lexim të mbarë!

Blerta Bodinaku

Eksperte e Shëndetit Mendor

Në shfaqjen e dinozaurëve

Në kopshtin e dinozaurëve ka festë. Të vegjlit do të japin një shfaqje para prindërve. Të gjithë janë të emocionuar. Dino këmbëshpejti lëviz pa pushim prapa perdes, Dada flokarta rrotullon bishtalecin me gishta, ndërsa Roro pi ujë vazhdimisht. Kur i pa miqtë e tij, Dinozauri Blu i pyeti: - Çfarë keni kështu?

- Unë kam frikë se mos ngatërroj vjershën, - i tha Dino pa ndaluar lëvizjen. - Mua më duket sikur i kam keq flokët kështu, - tha Dada.

Roro piu dhe një gotë me ujë dhe iu përgjigj shokut të tij:

- Unë dua të pi një liqen të tërë. Po nuk e piva, nuk do të këndoju dot.

Dinozauri Blu u çudit që shokët e tij po silleshin në atë mënyrë. Ai i tregoi edukatores atë që po ndodhte. Edukatorja erdhi pranë fëmijëve.

- Si jeni vogëlushë? - i pyeti ajo.

- Tani më duket sikur kam gëlltitur një top dhe më ka rënë në fund të këmbëve, edukatore, - tha Dada gati për të qarë. - Kam frikë se nuk do të kërcëju dot.

- Mua më ka ngecur zëri në stomak, - u ankua Roro.

Dinozauri Blu ishte i shqetësuar për shokët e tij. Edukatorja i tha se ata kishin pak frikë se mos nuk dilte shfaqja mirë. Ndaj nuk kishte asgjë të pazakontë në veprimet e tyre. Pastaj ajo u tha fëmijëve që të luanin pak në oborr derisa të vinte rad ha për t'u ngjitur në skenë. Di nozau ri Blu vendosi t'i ndihmonte shokët e tij. Kur erdhi koha që u ngjitën në skenë, ai duartrokiti fort dhe pas tij duartrokiten të gjithë. Dino, Dada dhe Roro morën zemër dhe filluan të recitonin, të kërcenin dhe të këndonin. Një çast

Dada nuk e vendosi mirë këmbën dhe u rrëzua.

- Oh, - thirri Dada nga dhimbja dhe u skuq e tëra nga turpi.

Dinozauri Blu duartrokiti përsëri edhe më fort se herën e parë. Zemra po i rrihte më shpejt. Ai ishte i vendosur ta ndihmonte shoqen e tij.

- Jepi Dada, çohu! - thirri ai me zërin që i dridhej nga emocioni.

Të gjithë filluan të thërrisnin “Dada, Dada!”. Dinozaurja e vogël u ngrit ngadalë. Ajo hodhi hapin e parë dhe iu duk sikur ai topi i rëndë u bë i lehtë dhe fluturoi si një tullumbace që e merr era. Dada ndjeu gëzim dhe buzëqeshi. Filloi të hidhte hapat pa



u dridhur më. Kur Dino, Dada dhe Roro mbaruan numrin e tyre, e gjithë salla u ngrit në këmbë.

- Ju lumtë! Urrra! - thirri me zë të lartë Dinozauri Blu.

Ai kërcëu tri herë nga gëzimi. Dadës iu mbushën sytë me lot kur pa se të gjithë po duartrokisnin, ndërsa Dino dhe Roro e përqaftuan fort. Edukatorja u bëri një fotografi të katër shokëve që qeshnin të lumtur dhe të çliruar nga emocionet e shfaqjes.

Për prindërit dhe edukatorët

Fëmijët gëzojnë të drejtën t'i shprehin të gjitha emocionet që ndiejnë. Të rriturit gabojnë kur përpiqen t'u mësojnë atyre t'i fshehin emocionet. Përkundrazi, ata duhet t'u mësojnë fëmijëve si t'i shprehin emocionet në mënyrën e duhur për të plotësuar nevojat që ata kanë. Mosshprehja e emocioneve nuk është njësoj me menaxhimin e tyre. Nëse u kërkojmë fëmijëve të ndrydhnin shprehjen e emocioneve, si për shembull, të mos qajnë, kjo nuk i ndihmon ata të mos kenë më dhimbje. Të shprehurit e emocioneve, qoftë me fjalë apo veprime, është mënyra e vetme se si fëmijët komunikojnë atë çfarë ndiejnë brenda. Kjo është mënyra e tyre për të lidhur botën e brendshme me atë të jashtme. Përndryshe, është si t'i kërkosh një zogu të mos cicërojë apo një maceje të mos mjaullijë. Ç'është më e keqja, kur fëmijëve u mësohet t'i ndrydhnin dhe t'i injorojnë emocionet, ato ruhen diku brenda tyre, duke krijuar në të ardhmen probleme nga më të ndryshmet, fizike dhe mendore.

Pyetje për fëmijët

- Si mendoni ju, pse Dino këmbëshpejti nuk rri dot pa lëvizur?
 - Po Dada flokarta, pse rrotullon vazhdimisht bishtalecin?
 - A mendoni se Roro është i etur vërtet? Nëse jo, atëherë pse kërkon vazhdimisht të pijë ujë?
 - Si do të ishit ndjerë ju në vendin e Dinos, Dadës dhe Roros?
 - Çfarë bëni ju kur jeni të emocionuar?
- Kush mendoni se mund t'ju ndihmojë kur ndiheni të emocionuar?
 - Pse u çudit dinosauri Blu me veprimet e miqve të tij?
 - A veproi mirë dinosauri Blu duke thirrur në ndihmë edukatoren?
 - Po ju, si do të kishit vepruar?
 - Si mendoni ju, si u ndje Dada kur u rrëzua?
 - Si mendoni se u ndje Dada kur dinosauri Blu duartrokiti fort, edhe pse ajo u rrëzua në skenë?

Një dragua në krevat

Tina nuk donte të flinte vetëm. Kur mami e puthte, i uronte natën e mirë dhe fikte dritën, ajo ia plaste të qarit. Sapo bëhej errësirë, i dukej sikur në dhomë hynin përbindëshat, magjistarët, gjarpërinjtë, kafshët e egra të përrallave dhe ... vogëlushja mbyllte sytë me doçka, që të mos i shikonte. Por, megjithatë i dukej sikur ata ishin aty dhe do t'i sulleshin.

Prindërit u përpoqën ta bindnin se përbindëshat e magjistarët janë vetëm trillime të përrallave, ndërsa gjarpërinjtë e kafshët e egra ndodhen aq larg, sa nuk arrijnë kurrë në shtëpitë tona. Por më kot, Tinës nuk i hiqej frika.

- Mos ma fik dritën! - i lutej mamit çdo natë dhe ia shtrëngonte dorën, gjersa e zinte gjumi. Edhe kur ndodhte të zgjohej natën, ia plaste të qarit sa tundej tërë shtëpia.

Si t'ia bënin prindërit me këtë çupën e tyre frikacake?

Një ditë babi i tregoi përrallën e dragoit i cili i mbylli në një vend përbindëshin që nxirrte flakë, kuçedrën me shtatë kokë dhe gjarprin me dhjetë gjuhë.

- Sa i fortë qenka ky dragoi! - u çudit vogëlushja. - I paska mbyllur të gjithë! Po tigrin?

- Tigrin jo, se ai jeton shumë larg. Por, po ta gjejë, edhe atij ia tregon vendin. - e siguroi babi.

- Nesër do të ma tregosh përsëri këtë përrallë? Qenka shumë e bukur!

Por të nesërmen babai bëri një gjë tjetër: Shkoi te dyqani i lodrave, bleu një



dragua të madh, sa vetë Tina dhe ia vuri mbi krevat.

Nuk thuhet dot me fjalë sa u habit dhe sa u gëzua ajo.

- Ua, sa i madh!... Ua, sa i bukur!...- thoshte ajo pa pushim, megjithëse dihet që dragoi është i fortë, por i bukur aspak. Mirëpo ja që asaj kështu i dukej.

Atë natë Tina diçka i pëshpëriti dragoit dhe e vendosi afër krevatit të saj. Kur mami erdhi ta puthë, dhe t'i urojë natën e mirë, Tina nuk i u lut “Mos e fik dritën!” as “Nëma dorën!”, por e përqafoi fort e fort, e puthi, i tha “Natën e mirë!” dhe e zuri gjumi...

Tani vogëlushja kishte një mik që e mbronte nga krijesat e frikshme.

Për prindërit dhe edukatorët

Gjatë rritjes, fëmijët, ashtu si të rriturit, provojnë frikëra që herë janë të bazuara e herë jo. Frikërat janë pjesë normale e rritjes. Fëmijët duhen ndihmuar që frikërat t'i kalojnë së bashku me të rriturit. Prindërit dhe edukatorët duhet të bëhen një urë e sigurt për të kaluar frikërat. Në moshën 3-7 vjeç, te fëmijët zhvillohen frikëra të ekzagjeruara, ankthe të rastësishme, makthe, ëndrra të këqija dhe forma të tjera të pasigurisë. Tipikisht, sjellje të papritura ankthioze te fëmijët e moshës parashkollore ose në ciklin fillor janë thjesht një fazë normale e rritjes, një tregues i rritjes së tyre konjitive. Paçka se duket e çuditshme, frikërat janë shenjë e pjekurisë! Fëmijët e moshës 3-6 vjeçare fillojnë të kuptojnë që prindërit e tyre nuk janë qenie të gjithëpushtetshme siç kishin besuar më parë. Ky perceptim mund të jetë shumë i mundimshëm për ta dhe shpesh u shkakton nervozizëm. Fëmijët vuajnë kur fillojnë të perceptojnë se ekziston një botë shumë e madhe jashtë shtëpisë së tyre, ku ata ndjehen aq të sigurt, dhe ajo është plot me rreziqe e të panjohura dhe mbi të gjitha: shumë, shumë e frikshme. Fëmijët ndihmohen të kuptojnë frikën, të flasin për të, dhe të ndihmohen ta menaxhojnë.

Pyetje për fëmijët

- *Pse Tina e mbante dritën ndezur?*
 - *Nga çfarë kishte frikë ajo?*
 - *Çfarë kafshësh shihte ajo?*
 - *Çfarë i tha mami dhe babi?*
 - *Si e ndihmuan ata Tinën?*
- *Çfarë i solli babai asaj?*
 - *Po ju, çfarë frikërash keni?*
 - *Tina mbante dritën hapur. Po ju çfarë bëni kur keni frikë?*
 - *Çfarë bëtë ju që të mos kishit më frikë?*

Shokët e ngushtë

Vetoni dhe Arbeni janë shokë të ngushtë. Ata tërë kohën rrinë bashkë. Bisedojnë, qeshin e luajnë futboll.

Vetoni është më i miri i lagjes, ai shënon shpesh gola. Kurse Arbeni gëzohet dhe mburret me shokun e vet.

Një ditë Arbenit i bënë dhuratë një kitarë. Ai prej kohësh kishte ëndërruar të bëhej muzikant dhe kitara i pëlqente pa masë, prandaj vendosi që të shkonte në shkollën e muzikës. Kur Vetoni dëgjoji se shoku i tij do të fillonte të mësonte kitarën, u kërkoi prindërve që edhe ai të shkonte në grupin e muzikës. Prindërit ia plotësuan dëshirën. Kështu që të dy shokët e ngushtë filluan të mësojnë kitarën.

Arbeni nisi t'i mësonte shumë shpejt notat. Ndërsa Vetoni, edhe pse përpiqej, nuk arrinte t'i mbante mend notat. Dita-ditës Arbeni përparonte më shumë, kurse Vetoni mbetej mbrapa.

Një ditë mësuesi i kitarës e përgëzoi Arbenin: "Të lumtë Arben, ke vesh të mirë për muzikë!" Vetonit nuk i tha gjë.





Arbeni i gëzuar e Vetoni i mërzhitur u nisën për shtëpi.

- Dëshiron të ushtrohemi bashkë sot? - e pyeti Arbeni.

- Jo! - tha Vetoni - ti kujton se je më i zoti se unë në kitarë, vetëm se të lavdëroi mësuesi? Po të dua, e mësoj kitarën për një ditë, por mua s'më pëlqen ky instrument koti. Është vetëm për çunat me veshë të mëdhenj si ti.

Arbeni u mërzhit shumë nga fjalët e shokut, por nuk tha asnjë dhe heshti.

Me të ardhur në shtëpi, Vetoni e mori kitarën dhe e futi thellë në dollap. "Instrument koti" - mendoi. Prindërve u tha që nuk do të shkonte më në orën e muzikës, sepse nuk i pëlqente kitara. Që prej asaj dite ai shmangte çdo bisedë lidhur me kitarën. "Nuk më pëlqen dhe kaq!" - thoshte. Në të vërtetë, brenda vetes e ndiente që nuk ishte i sinqertë.

Ndërkohë ai vazhdonte të luante futboll me shokët e lagjes, kurse Arbeni i vëzhgonte nga larg. Sa herë që Vetoni shënonte gol, të gjithë shokët e brohorisnin, por Vetoni përsëri nuk ndihej mirë. Ai nuk i dëgjonte më thirrjet e shokut të tij, Arbenit, i cili më parë, për çdo gol që shënonte, thërriste me sa zë kishte në kokë "të lumtë Veton!". Teksa loja po mbaronte, Vetoni vuri re shokun e tij që po largohej kokulur. Iu kujtuan fjalët që i kishte thënë dhe mendoi: "Arbeni çdo herë është gëzuar për golat e mi, duke u krenuar me mua, ndërsa unë u mërzhita pse ai është më i mirë sesa unë në kitarë".

Ai e thirri Arbenin dhe kur të dy u gjendën përballë njëri-tjetrit, Vetoni i kërkoi të falur: - Më fal! Dua që të jemi shokë si më parë. - i tha ai.

Arbeni i zgjati dorën dhe u pajtuan.

- Do të vish sërish në orën e muzikës? - e pyeti Arbeni.

- Jo, nuk është për mua, - tha Vetoni - por mund të luaj me ty ndonjëherë, nëse pranon. - Patjetër që po! -tha Arbeni dhe shtoi: -Veton, ti je më i miri i lagjes në futboll dhe sot bërë shumë gola.

- Edhe ti je më i miri në kitarë!- iu përgjigj Vetoni.

Të dy shokët u përqaftuan dhe qysh nga ajo ditë u bënë miq më të mirë.

Për prindërit dhe edukatorët

Kjo përrallë thekson rëndësinë e njohjes së emocioneve dhe shprehjes së tyre. Mirëqenia emocionale te fëmijët zhvillohet nën ndikimin e prindërve, të motrave dhe/ose vëllezërve dhe të bashkëmoshatarëve, të cilët u mësojnë fëmijëve se si t'i kuptojnë, t'i shprehin dhe të përgjigjen ndaj emocioneve të ndryshme. Ndërveprimi me prindërit në vitet e para të jetës kontribuon në zhvillimin e aftësive të fëmijëve për të shprehur dhe për të kontrolluar emocionet.

Fëmijët e kanë të vështirë t'i kontrollojnë emocionet. Të kuptuarit fillestar rreth strategjive të kontrollit të emocioneve bazohet në të kuptuarin e emocioneve. Jo rrallëherë ndodh edhe e kundërta: është pikërisht të kuptuarit e emocioneve nga ana e fëmijëve ajo që pengon rregullimin e tyre. Për shembull, kur fëmijët e kuptojnë lidhjen mes hidhërimit dhe dëshirave të paplotësuara, ata mund të këmbëngulin keqazi për të arritur atë që duan në mënyrë që të ndjehen më mirë. Vetëm pas moshës 6 vjeçare fëmijët arrijnë të mësojnë dhe të përdorin strategji të kontrollit të emocioneve, si modifikimi i mendimeve dhe riformulimi konjitiv i situatës.

Sa më mirë ta njohin veten fëmijët, aq më të aftë janë të kontrollojnë emocionet.

Pyetje për fëmijët

- Kush ishin Vetoni dhe Arbeni?
 - Çfarë ëndërronte të bëhej Arbeni kur të rritej?
 - Pse vendosi Arbeni të shkonte në shkollën e muzikës?
 - Ç'bëri Vetoni kur shoku i tij i ngushtë u regjistrua në shkollën e muzikës?
 - Si mendoni ju, pse u mërzhit Vetoni kur mësuesi lavdëroi Arbenin?
 - Po ju, si ndiheni kur dikush lavdëron shokun/ shoqen tuaj të ngushtë?
 - Si u soll Arbeni me shokun e tij?
 - Po ju, si do ishit sjellë në vendin e tij?
- Ç'bëri Vetoni në vazhdim të tregimit?
 - A do të silleshit edhe ju si Vetoni?
 - Si mendoni ju, si u ndje Vetoni për sjelljen e tij me Arbenin?
 - A e kuptoi Vetoni gabimin?
 - Si e rregulloi ai gabimin?
 - A do ta kishit falur ju shokun ose shoqen nëse ai/ajo do të ishte sjellë si Vetoni?
 - A keni gabuar ndonjëherë me shokët apo shoqet?
 - A ju kanë falur shokët dhe shoqet për gabimet që keni bërë?
 - Si i falni ju shokët dhe shoqet?

Adriani i vogël dhe deti i madh

Në shtëpinë pranë bregut të detit jetonte Adriani pesëvjeçar me prindërit dhe vëllanë e vogël. Më shumë nga të gjitha stinët atij i pëlqente vera. Sapo fillonte kjo stinë, Adriani më të shumtën e kohës e kalonte plazh. Vraponte pas topit, ndërtonte kulla në rërë dhe freskohej në ujë. Në njërin nga këto ditë të bukura të verës, kur deti ishte i qetë dhe i ngrohtë, në plazh ishte ngritur flamuri i gjelbër, për të treguar se deti ishte i sigurt për notarët. I ulur në breg Adriani po ndërtonte një kështjellë prej rëre, por nuk ishte i kënaqur. Mendjen e kishte te disa fëmijë që po bënëin gara me not dhe duke u hedhur edhe nga shkëmbi.

Babai i Adrianit e kuptoi se çfarë po e mundonte të birin, prandaj i tha:

- Adrian, së shpejti do të notosh edhe ti si shokët. Ja, shiko sa shpejt po rritesh, dhe pak dhe do të jesh edhe ti po aq i zoti sa ata djemtë.

Por Adriani atë ditë u kthye i mërzitur nga plazhi. Gjithë rrugës mendonte për notin deri te shkëmbi dhe kërcimin në ujë. Dëshironte shumë ta provonte njëherë, por kishte frikë se mos e shikonte ndokush.

Atë natë ra shi. Dita zbardhi e vranët dhe me erë. Në det valët e bardha përplaseshin me njëra-tjetrën, ndërsa plazhi ishte i braktisur nga njerëzit. Që nga oborri i shtëpisë Adriani pa flamurin e kuq në breg të detit. E dinte, ia kishte treguar babai, ajo shenjë tregonte që notimi është i rrezikshëm dhe i ndaluar. Por Adriani e kishte vendosur. Fshehurazi do të dilte nga oborri, do të shkonte në plazh dhe do të notonte deri te shkëmbi. Prej aty pastaj do të kërcente në det. Ai mendonte se,



meqë nuk mund ta shihte njeri, nuk do të kishte kush të tallej me djalin e vogël, nëse ai nuk arrinte dot deri te shkëmbi.

Vështroi brenda shtëpisë. Babai po pastronte peshkun, kurse nëna po i lexonte diçka vëllait të vogël. Me shpejtësi doli nga shtëpia, u zhvesh dhe me një frymë u gjend pranë ujit. Valët e ftohta u përplasën në këmbët e tij sikur të ishin shkumëza bore të ftohta. Edhe pse e ndjeu që do të ishte me rrezik, nuk hoqi dorë. Me guxim filloi të notojë drejt shkëmbit. Një valë më e madhe u zbraz përpara tij, e mbuloi dhe Adrianit i hyri uji në gojë dhe në hundë. U kollit dhe u mundua të drejtohej që të prekte me këmbë tokën. Por deti aty ishte më i thellë. E kaploi frika dhe provoi të kthehej. Si nëpër mjegull vërejti babin e tij, që me not të shpejtë po afrohej, derisa e kapi fort. I lumtur, Adriani ia shtrëngoi dorën dhe e ndjeu veten të sigurt dhe u qetësua.

Kur doli në breg nuk po e kuptonte nëse ishin lotët apo pikat e ujit që rridhnin prej syve të e tij. Ashtu nëpër lot, ai e kuptoi çfarë gabimi kishte bërë që ishte larguar i vetëm në det, pa u thënë prindërve dhe duke rrezikuar jetën e tij.

Atë ditë Adriani i premtoi babit që jo vetëm do të respektonte rregullat e sigurisë, por do të kujdesej që edhe miqtë e tij t'i mësonin ato.

Për prindërit dhe edukatorët

Siguria është një nga shtyllat e edukimit të fëmijës nga familja dhe kopshti. Kohë para se të mësojnë të flasin apo të ecin vetë, fëmijët nisin të marrin nga të rriturit mësimet e para për sigurinë fizike dhe atë emocionale. Është detyrë e të rriturve t'u ofrojnë fëmijëve mbështetje, dashuri, drejtim dhe mbrojtje.

Mësimi dhe praktikimi i aftësive të mbrojtjes së vetes i ndihmon fëmijët jo vetëm të jenë më të sigurt, por edhe të kenë më pak ankth, më shumë vlerësim për veten dhe të zhvillojnë kompetenca nga më të ndryshmet. Fëmijët e moshës parashkollore mund dhe duhet të mësojnë teknika të dobishme për si të reagojnë apo të përgjigjen në situata të rrezikshme.

Të rriturit shpesh mendojnë se duke u përmendur fëmijëve gjërat e këqija ose të rrezikshme që mund t'u ndodhin, ata do të mësojnë si të mbrohen. Në fakt, kjo vetëm sa u shton fëmijëve ankthin. Fëmijët e kanë të nevojshme të udhëzohen dhe të trajtohen për të praktikuar aftësitë e mbrojtjes së vetes. Mos harroni, fëmijët mësojnë më mirë me anë të shembujve konkretë. Fëmijëve u duhet mësuar si të veprojnë hap pas hapi në mënyra të sigurta në situata të rrezikshme, deri kur të jenë në gjendje të përballen me rreziqet dhe pasiguritë.

Pyetje për fëmijët

- Si mendoni ju, pse i pëlqente shumë stina e verës Adrianit?
- Si e kalonte ai kohën në plazh?
- Çfarë tregon flamuri i gjelbër në plazh?
- Po ai i kuq?
- Çfarë dëshironte të bënte Adriani?
- Çfarë plani bëri ai për të realizuar dëshirën për të notuar?
- Po ju, si do të kishit vepruar në vendin e tij?
- A është i sigurt deti kur valëvitet flamuri i kuq?
- Çfarë gabimi bëri Adriani?
- Çfarë premtimi i bëri babait Adriani?
- A besoni se do ta mbajë fjalën?
- Si ndiheni ju kur bëni gabime?

Dardha e papjekur

I shte pranverë. Livadhet kishin gjelbëruar dhe pyjet ishin mbushur me gjethe. Para shtëpisë, në barin e njomë, çdo ditë bënin gjimnastikë dy arushët, Bruna dhe Brundo. Ndërsa vëllai i tyre Buçko rrinte i shtrirë në bar duke ngrënë ëmbëlsira.

- Mjaft më me ëmbëlsira! - i tha nëna - Tani është koha për fruta dhe perime të freskëta.

Por Buçkoja pëlqen më shumë kekun dhe mjaltin. Nuk e dëgjon nënën dhe përtypet me ëndje. Ai çuditet sesi vëllai dhe motra mund të luajnë pandërprerë. Ai nuk mund të luajë gjatë, sepse lodhet .

“Të vraposh pas topit është lojë koti ! Më mirë është të shtrihem në bar dhe të pushoj”- mendonte Buçko. Motra dhe vëllai e thërrisnin për të luajtur së bashku, por arushi dembel i kundërshtonte me një lëvizje dore.

“Ouuu, - thoshte Buçkoja duke prekur barkun e rrumbullakët me dorë, ndërsa vazhdonte të rrinte shtrirë - nuk kam kohë.”

Një ditë, kur Bruna dhe Brundo ishin nisur për të shkuar në pyll, e ftuan dhe vëllanë dembel.

- Eja me ne, pylli në këtë stinë është i bukur, kanë filluar të piqen luleshtrydhet. Buçkoja, duke përtuar, u nis ngadalë pas tyre. I pëlqeu me të vërtetë ajri i freskët në pyll dhe u gëzua kur gjeti dy luleshtrydhe të pjekura. I hëngri ato me kënaqësi dhe vazhdoi të kërkonte të tjera. Por shpejt u mërzit, sepse për çdo luleshtrydhe të vogël duhej të ulej për ta këputur. “Kur do ta mbush unë këtë stomak të madh me këto



fruta kaq të vogla?” - mendoi Buçkoja i mërzitur.

Ngriti kokën dhe pa një dardhë të gjelbër. “Nuk më duket e pjekur, - mendoi ai - por sikur ta haja, do të ngopesha menjëherë. Qenka më e madhe se luleshtrydhja dhe duhet të ketë njëqind herë më shumë vitamina...”

Dardha ishte aq e papjekur dhe e thartë, saqë nuk mund të hahej, por Buçkoja, i vendosur për të shuar urinë, e gjeti mënyrën për ta ngrënë. Nxori nga qesja shishen me mjaltë dhe dardhën e thartë e ngjyente në mjaltin e ëmbël.

- Frutat e papjekura nuk hahen, do të të dhembë stomaku, - i tha Bruna.

- Ku e di ti? - i tha Buçkoja. - Kur e ngjyey dardhën në mjaltë edhe ajo ëmbëlsohet.

Kur arritën në shtëpi Buçkos filloi t'i dhembte stomaku. Mami i përgatiti çaj kamomili dhe arushi nisi ta pinte.

- Buçko, frutat dhe perimet janë ushqimi më i shëndetshëm, por vetëm kur janë të pjekura. Shpresoj që sot ta kesh kuptuar - i tha nëna.

Buçkoja, duke mbajtur barkun me dorë, tha:

- Oh mami, s'do të më bjerë më ndërmend, kurrë, të ha fruta të papjekura.

Vëllai, motra dhe nëna u kujdesën që Buçkoja të shërohej sa më shpejt. Të nesërmen, ai ndihej më mirë dhe doli bashkë me vëllanë dhe motrën që të bënte gjimnastikën e mëngjesit.

Për prindërit dhe edukatorët

Në ditët e sotme, problemet kryesore të ushqimit dhe të sjelljeve që lidhen me të të fëmijët e moshës parashkollore janë kequshqimi, uria, mbipesha dhe obesiteti. Që në moshë të vogël, ata mësohen të parapëlqejnë dhe të konsumojnë patatet e skuqura dhe të tjera produkte pak ose aspak të shëndetshme për ta. Mbipesha në fëmijëri është e lidhur me mbipeshën në moshë madhore. Edukimi për ushqimin e shëndetshëm është detyrë e prindërve dhe kopshtit. Fëmijët duhet të ekspozohen ndaj ushqimeve të shëndetshme në familje. Këto ushqime duhet të konsumohen nga të gjitha anëtarët e familjes dhe duhet të shpjegohen arsyet përse janë të rëndësishme. Ushqimet e pashëndetshme ndoshta duhen lënë vetëm për një herë në javë, ose më shumë pasi nuk mund të kufizohen fëmijët në mënyrë kaq strikte nga ajo që shohin në rrugën apo televizor.

Pyetje për fëmijët

- Si mendoni ju, pse bëjnë gjimnastikë çdo ditë dy arushët?
 - Pse nuk do të luajë arushi Buçko?
 - Pse nuk pranon ai të luajë më vëllain dhe motrën e tij?
 - Çfarë ndodhi kur shkuan në pyll arinjtë e vegjël?
 - Çfarë gjetën ata në pyll?
 - Pse u mërzi shpejt ariu Buçko?
 - Çfarë bëri Buçkoja me dardhën e papjekur?
 - Si e këshilloi motra Buçkon?
- Pse nuk e dëgjoi Buçkoja këshillën e motrës?
 - Çfarë i ndodhi Buçkos pasi hëngri dardhat e papjekura?
 - Çfarë mësoi Buçkoja nga ajo që i ndodhi?
 - A mendoni se e kuptoi ai gabimin?
 - A keni provuar ndonjëherë fruta të papjekura?
 - Cilat janë frutat dhe perimet që ju pëlqejnë më shumë?
 - Cilat janë ushtrimet gjimnastikore që pëlqeni më shumë?

Elsa dhe Joni

Fkush nuk e njeh Elsën, atë vajzën katërvjeçare që banon te pallati i kaltër! Ngaqë është përherë e qeshur, ajo është e pëlqyera e të gjithëve. Por prej disa muajsh Elsa ka qenë në qendër të vëmendjes. Elsa do të bëhej me vëlla. Ajo kishte kohë që e priste ardhjen e tij. Vogëlushja u tregonte të gjithëve për të, madje ajo ia kishte zgjedhur edhe emrin. Joni do ta quanin.

Kur Joni erdhi në shtëpi, Elsa u gëzua shumë. Ajo përpiqej ta ndihmonte mamën që kujdesej për beben dhe kishte dëshirë të bënte gjithçka vetë. Por, edhe pse u kënaq që familja e saj u bë më e madhe, përsëri kishte diçka që nuk e linte të qetë.

Ndërkohë që ditët kalonin, shqetësimi i saj sa vinte dhe rritej. Kur e thërriste mamën që të ngjyrosnin së bashku librin me princesha, ajo rastiste të ishte e zënë duke e ndërruar Jonin. Kur kishte dëshirë të lexonte përrallat para gjumit, me babin, Joni qante dhe bënte zhurmë në dhomë. “Uf, edhe ky Joni, që s’na lë të bëjmë asgjë si përpara...”, i thoshte ajo mamit.

Prindërit i shpjegonin vazhdimisht që bebet e vogla kanë nevojë për kujdes të madh në muajt e parë. Ata i kujtonin Elsës se kështu ishin kujdesur edhe për të kur kishte qenë e vogël. I tregonin sesi babai e kishte mbajtur në krahë derisa ta zinte gjumi, apo sesi mami i kishte kënduar ninullat më të bukura derisa ajo t’i mbyllte syçkat e bukur. Por Elsa nuk bindej.

Një fundjavë familja shkoi për shëtitje nga pishat. Babai mbante Jonin në krahë, sepse ai nuk donte të rrinte më në karrocë, kurse Elsa ecte përdore me mamën, e cila



i tregonte luledelet në bar. Por Elsa shikimin e kishte vetëm te Joni. Pas disa minutash ajo filloi të ankohej:

- Mami, unë jam lodhur.

- Të lutem, zemra e mamit, duro edhe pak se arritëm.

- Më merr edhe mua në krahë si Jonin.

- Po ti je e madhe, zemra ime.

- Uf, uf ! S'mund të eci më, le të më marrë babi, le ta lëshojë Jonin. Joni ka karrocën...

- Elsa, ulu e pusho pak në karrocën e Jonit.

- Jo, nuk dua ! Unë dua të më mbani në krahë si Jonin - tha Elsa dhe shpërtheu në lot.

- Unë nuk mund ta shoh vajzën time të mërzitur - tha babi dhe e mori në njërin krah Elsën. Në tjetrin kishte Jonin. - E sheh, Elsa? Unë mund t'ju mbaj të dyve.

Elsa e shikonte Jonin që i qeshte asaj, i prekte fytyrën dhe gugaste sikur donte t'i thoshte se ajo ishte motra e tij më e mirë. Elsa filloi të qeshte përsëri. Kur shikonte Jonin, i dukej sikur shqetësimi i ditëve të shkuara po largohej.

- Elsa, ne të duam shumë edhe ty edhe Jonin ! - i tha babi, që kishte filluar të lodhej pak.

- Por ju doni pak më shumë Jonin, se është më i vogël... - u ankua Elsa.

- Edhe mami edhe babi i duan njësoj fëmijët e tyre. Dashuria nuk ndahet si mollët që të jep babi çdo mëngjes - i tha mami.

Elsa buzëqeshi dhe sytë përsëri i shkuan te Joni. Ai vazhdonte të qeshte dhe të

lëshonte tinguj. Befas ata tinguj iu dukën Elsës si kënga më e bukur në botë. Kur vëllaçkoja i preku faqet me duart e vogla, Elsa u ndje shumë e lumtur. Ajo pa babin që po lodhej duke i mbajtur të dy në krahë, pa u ankuar asnjë çast. Pastaj i tha:

- Të lutem, babi, unë dua të eci vetë.

Zbriti nga krahët e babit dhe filloi të mblidhte lule me mamin. Elsa ndihej e lehtë si një flutur dhe donte vetëm të qeshte. Vraponte dhe luante gjithë kohën me vëllanë e saj. Edhe mami dhe babi filluan të luanin me fëmijët e tyre dhe të gjithë bashkë kaluan një ditë shumë të bukur.

Për prindërit dhe edukatorët

Lindja e fëmijës së dytë në familje shenjon fillimin e ndërveprimit mes vëllezërve dhe motrave. Kalimi nga një në dy fëmijë që kanë moshë të përafërt sinjalizon një periudhë përshtatjeje për të gjithë anëtarët e familjes. Kur fëmija e parë është rreth 3 - 4 vjeç, ajo/ai angazhohet më shumë me të porsalindurin, ndërsa kur është më e vogël, rreth 1- 2 vjeç, është më e shqetësuar apo bezdisur prej bebes së porsalindur dhe lidhet më shumë pas prindit. Janë të njohura rastet kur, pas një muaji nga lindja e bebes, fëmija më e rritur shfaq probleme me tualetin, gjumin, dhe bëhet e pabindur, sidomos në raste kur nëna është duke u kujdesur ose duke ushqyer foshnjën. Fëmijët mund të bëhen xhelozë për shkak të vëmendjes që merr i porsalinduri. Ata e shfaqin xhelozinë nëpërmjet sjelljeve negative. Djemtë shpesh kundërpërgjigjen duke u bërë më të tërhequr pas lindjes së fëmijës së dytë, ndërsa vajzat shfaqin më shumë sjellje varësie, si për shembull bëhen grindavece, u ngjiten prindërve, veçanërisht kujdestarit kryesor, ose rifillojnë përdorimin e biberonit. Sjelljet më problematike vihen re kur fëmijët janë të së njëjtës gjini.

E rëndësishme është që fëmijët të ndihmohen dhe kuptohen gjatë kësaj kohe dhe të mos gjykohen për emocionet e tyre. Kjo fazë tranzicioni ka nevojë për udhëheqje të ndjeshme nga prindërit dhe të rriturit.

Pyetje për fëmijët

- A besoni ju se prindërit e donin më pak Elsën pas lindjes së Jonit?
 - Si mendoni ju, pse mendonte Elsa se prindërit e donin më pak?
 - A mendoni dhe ju se Joni ishte i lezetshëm dhe i dashur?
 - Si e priti Elsa ardhjen e vëllait?
 - Pse këmbëngulte Elsa të flinte në një dhomë me prindërit?
 - Si mendoni ju, pse filloi të shqetësohej Elsa?
- Çfarë ndodhi kur familja doli në fundjavë?
 - Pse Elsa shpërtheu në lot atë ditë?
 - Çfarë e bëri Elsën të qeshte përsëri?
 - Si nisi ta donte Elsa Jonin?
 - Cilat fjalë të prindërve e bënë Elsën të ndihej më mirë?
 - A keni ju vëllezër apo motra?
 - Si keni reaguar ju pas lindjes së vëllait ose motrës suaj?
 - A jeni ndjerë ju ndonjëherë si Elsa?

Kush e shëroi elefantushin?

- e vërtetë -

Tufa e elefantëve u nis për shtegtimin e zakonshëm. Andej nga fundi mezi çapitej një elefanteshë, me barkun të fryrë, që mbante brenda një bebush. Pranë saj ecnin babi dhe “djali” i madh.

Dhe ja, çasti erdhi: elefantushi u lind. E tërë tufa u ndal të priste gjersa ai të ngrihej e të ecte pranë prindërve. Por vogëlushi nuk lëvizte dot këmbët. Mami, babai dhe vëllai përpiqeshin ta ngrinin, me feçkat e tyre, por më kot.

Kaloi një kohë e gjatë. Tufa u mërzit duke pritur. I pari i fisit u tha:

- Më vjen keq, por i vogëli është shumë sëmurë, nuk e dimë nëse e presim dot. Ejani të nisemi! - Jo! - kundërshtuan prindërit - ne do të mbetemi këtu, me foshnjën tonë. Ndërsa ti, zemër, - i thanë “djalit” më të madh - shko me tufën!

- Edhe unë do të rri këtu - u përgjigj ai. - Vëllaçkoja ka nevojë për dashurinë e ndihmën tonë. A nuk më keni mësuar ju vetë se në familje duhet ta duam shumë njëri-tjetrin? Dhe jo vetëm ta duam, por duhet edhe ta mbështesim njëri-tjetrin.

E ëma e puthi. I ati ia kapi feçkën me feçkën e tij të madhe dhe i buzëqeshi krenar.

Të tre, çdo çast, i bënë masazh të voglit, përpiqeshin t’ia lëviznin këmbët. Mama elefantësja ia shtrydhte qumështin në gojë. Elefantushi i shikonte me sytë e tij të ëmbël e falënderues.

Kaluan disa ditë. Ata hanin shumë pak, flinin pak, nuk u dorëzuan në asnjë çast. Bënë të pamundurën. Dhe ja, për çudinë e lumturinë e pafund të familjarëve, një



mëngjes vogëlushi lëvizi këmbët dhe ... qëndroi në këmbë! Dalëngadalë filloi të hedhë hapat e të ecë...

Elefantushin e shëroi dashuria dhe përkujdesja e familjes, që është më e madhja në botë. Pa to, ai nuk do t'ia kishte dalë dot!

Për prindërit dhe edukatorët

Përgjegjësitë në familje fëmijëve u mësohen nga prindërit që në moshë të hershme, madje shumë më herët nga sa mendojnë prindërit. Përgjegjësia është aftësi që duhet përvetësuar për të ndihmuar veten dhe anëtarët e familjes. Fëmijët, mund dhe duhet të marrin përsipër përgjegjësi për ta bërë botën më të pastër, më të sigurt dhe një vend më të mirë për të jetuar. Nëse prindërit dëshirojnë që fëmijët të zhvillojnë vetëbesimin dhe të mësojnë të marrin përsipër përgjegjësi, atëherë duhet t'u japin fëmijëve punë dhe përgjegjësinë për të bërë atë që i jepet. Mosbesimi se fëmijët mund t'ia dalin, jo vetëm që është frustruese për fëmijën, por mund të lëndojë vetëbesimin. Fëmijët duhet të lejohen dhe të inkurajohen që të kujdesen sa më shumë për veten. Kërkimet gjithashtu tregojnë se fëmijët që angazhohen me kujdesin për veten dhe punët e shtëpisë janë të përgjegjshëm dhe përgjithësisht të aftë të sillen përshtat situatave.

Pyetje për fëmijët

- Ku po shkonte tufa e elefantushëve?
 - Çfarë ndodhi gjatë rrugës?
 - Çfarë kishte elefantushi i vogël?
 - Çfarë po i bënin mami dhe babi elefantushit të vogël?
 - Pse iku tufa e elefantushëve?
 - Çfarë i tha babi vëllait të madh?
- Po vëllai i madh si u përgjigj?
 - Si mendoni ju se veproi vëllai i madh?
 - Po ju, si do të kishit vepruar? Përse?
 - Kush e shëroi elefantushin?
 - Kur jeni sëmure, kush kujdeset për ju?
 - Po ju çfarë bëni kur dikush në familje sëmuret?
 - Si u ndjetë kur lexuat këtë përrallë?

Shumë dashuri për Gulunë

Guluja është një pinguin i vogël. Ai ka dy prindër që e duan shumë. Por, prej pak kohësh, prindërit e tij kishin filluar të mos merreshin vesh me njëri-tjetrin. Guluja i shihte kur ata flisnin dhe vinte re se diçka kishte ndryshuar. Derisa një ditë mami dhe babi i thanë pinguinit Gulu se nuk do të jetonin më bashkë. Vogëlushi nuk foli fare. Iu kujtuan ditët e bukura që kishin kaluar së bashku dhe nuk e kuptonte përse të rriturit merrnin vendime të tilla. Të dy prindërit përpiqeshin vazhdimisht që t'i shpjegonin djalit të tyre atë që kishte ndodhur, por ai nuk donte të dëgjonte.


- Kur ndihen mirë, të rriturit vendosin të rrinë bashkë. Kur nuk ndihen mirë bashkë, vendosin të jetojnë më vete, - i thoshte mami.

- Ju nuk më doni mua, - ua kthente shkurt Guluja.

- Nuk është aspak e vërtetë, - thoshte mami. - Ne të duam shumë!

- Mami thotë të vërtetën, - përgjigjej babi. - Të duam shumë, shumë!

Deri ditën kur babi iku në shtëpinë e re dhe Guluja qëndroi për të jetuar me mamin, pinguini i vogël ishte i bindur se prindërit e tij nuk e donin aq sa thoshin. Ditët kalonin. Guluja kishte filluar të ushtrohej për lojërat në akull, që zhvilloheshin në dhjetor të çdo viti. Gjatë stërvitjes njëherë e shoqëronte mami dhe një herë tjetër babi. Por Guluja dëshironte që ta shoqëronin të dy bashkë... Dita e madhe e garës mbërriti. Guluja ishte plot emocione për kërcimin mbi akuj. Por ai mendonte gjithashtu edhe për mamin e babin. Hodhi sytë në stolat prej akulli ku duhej të uleshin prindërit e



Gulu, të duam shumë!

tij dhe kur i pa të zbrazët, mendoj se ata nuk e donin dhe aq shumë... Kërcimi i parë mbi tre akuj njëherësh ishte i lehtë dhe Guluja ia doli mbanë. Tani e kishte radhën një kërcim i vështirë dhe pinguini i vogël nuk e dinte nëse do ta kalonte. Teksa mendohej, dëgjoji zërat e shokëve:

- Gulu, shiko, kanë ardhur mami dhe babi!

Guluja kthehu kokën nga stolat dhe pa prindërit e tij të ulur bashkë. Në atë çast mami dhe babi ngritën një tabelë të madhe e të bardhë ku ishte shkruar: “Gulu, të duam shumë!” Guluja mori zemër dhe kërcëu mbi akullnajën e madhe. Në fund të garës ai fitoi një kupë akulli. Bashkë me mamin dhe babin shkuan për të festuar. Guluja tani ishte më i qetë. Ai e kuptoi se mami dhe babi e donin shumë, shumë djalin e tyre dhe do të ishin gjithmonë pranë tij.

Për prindërit dhe edukatorët

Ndarja ose divorci i prindërve shpesh kanë pasoja të dëmshme për funksionimin psikologjik dhe shoqëror të fëmijëve, si dhe mirëqenien e përgjithshme të tyre gjatë fëmijërisë dhe më tej. Fëmijët, të cilët ose nuk e njohin fare njërin prind biologjik, ose e njohin shumë pak, përjetojnë gjendje paqartësie dhe pasigurie. Kjo gjendje pasigurie të fëmijët mund të shkaktojë zhvillimin e imazhit të pasigurt për veten dhe ndjesi të paqartë të identitetit në adoleshencë dhe më tej. Hendeqe të tilla në jetën e fëmijës shkaktojnë ndjesinë e vetes së fragmentarizuar apo të copëzuar. Njerëzit kanë një nevojë të brendshme për të kuptuar lidhjet shkak-pasojë, prandaj dhe pamjaftueshmëria apo mospërputhja e informacionit në lindje ose biografi rezulton në një gamë fantazish dhe mungesë qetësie mendore.

Pasojat negative të rritjes me një prind mund të zbuten pjesërisht nëse prindërit që nuk banojnë me fëmijët mbajnë marrëdhënie të ngushta me ta. Shpeshësia dhe cilësia e këtyre marrëdhënieve është e lidhur

drejtpërdrejtë me mirëqenien e fëmijëve. Fëmijët që kanë lidhje të forta me të dy prindërit pas ndarjes ose divorcit, kanë koncept më të zhvilluar të vetes. Po ashtu, kur prindi që nuk jeton me ta zhvlerësohet ose mohohet me kalimin e kohës, besimi i fëmijëve zvogëlohet. Identiteti dhe vetëvlerësimi i fëmijëve është më i fortë kur ai merr informacion të plotë, të vazhdueshëm dhe pozitiv ndarjen, si dhe kur prindërit, pavarësisht se të divorcuar përpiqen të ruajnë të njëjtën linjë në edukimin e fëmijës, pa rënë pre e lojrave të pushtetit midis njëri-tjetrit.

Pyetje për fëmijët

- Si mendoni ju, pse u mërzi Guluja?
 - Pse nuk u besonte Guluja prindërve kur ata i thoshin që e donin shumë?
 - Po ju, a besoni e prindërit e donin shumë Gulunë?
 - Pse babai i Gulusë nuk jetonte më me të?
- Me kë jetonte tani Guluja?
 - Si ia treguan prindërit dashurinë Gulusë?
 - Si ua tregojnë dashurinë prindërit fëmijëve?
 - Po ju, si do të ndiheshit nëse prindërit do t'u thoshin se po ndahen?
 - Me kë bisedoni kur nuk ndiheni mire?

Fluturimi i fundit

Toni e donte shumë Papin. Miku i tij ishte një papagall i madh, me pendë të verdha, me sqep të kuq dhe kokë jeshile. Çdo ditë Toni i jepte për të ngrënë dhe luante me zogun. Në miqësinë e papagallit koha kalonte pa kuptuar, derisa një ditë Papi nuk u ndje mirë. Toni vuri re se miku i tij po qëndronte pa lëvizur. Provoi t'i jepte disa fara, por Papi as kokën nuk e zgjati. I afroi ujin, por zogu nuk piu asnjë pikë. I shqetësuar, Toni u tregoi prindërve. Kur e panë Papin në atë gjendje, ata vendosën që ta dërgonin në spitalin e kafshëve. Mjeku i kontrolloi temperaturën dhe grykët, sytë dhe krahët. Pastaj i bëri një gjilpërë dhe tha:

- Më vjen keq, por zogu është shumë sëmurë. E vetmja gjë që mund të bëni është që ta lini të fluturojë për herë të fundit...

Toni u mërzit. Si mund të rrinte ai pa mikun e tij? Pas gjilpërës Papi ndihej më mirë dhe Toni u gëzua. Por të nesërmen në mëngjes zogu qëndronte përsëri i lodhur në një cep të kafazit. Tonit iu kujtuan fjalët e mjekut.

- Mami, nuk më pëlqen kur e shikoj Papin kështu. Ai nuk lëviz, nuk ha, nuk luan me mua.

- Papi është sëmurë, - i tha mami.

Toni u mendua pak. Ai pa sytë e lodhur të papagallit dhe iu kujtuan përsëri fjalët e mjekut. Nuk mund ta mbante në kafaz vetëm sepse do ta merrte malli! Duhej ta linte të bënte fluturimin e tij! Të nesërmen Toni u tha prindërve se kishte vendosur ta linte të lirë Papin. Të tre së bashku hapën deriçkën e kafazit, e përkëdhelën dhe i



thanë lamtumirë.

- Mos më harro! Unë do të të kujtoj gjithmonë! - i premtoi djali.

Papi afroi kokën te dora e vogëlushit. Toni e përkëdheli përsëri dhe e lëshoi në ajër. Ai e ndoqi me sy fluturimin e zogut, derisa Papi u zhduk pas një reje. Prej asaj dite, koha kalonte shumë ngadalë. Tonin po e merrte malli shumë për Papin. Një mëngjes ai pa babin që mbante në dorë një letër dhe lapsat me ngjyra.

- Ke dëshirë të vizatosh Papin? - e pyeti ai.

Teksa ngjyoste pendët e verdha, Toni filloi të ndihej sikur Papi ishte aty pranë tij. Kur mbaroi vizatimin, e vuri pranë shtratit dhe i tha natën e mirë. Nga dritarja, hëna hodhi rrezet e saj mbi papagallin prej letre, ndërsa gjumi përkëdheli qepallat e vogëlushit.

Për prindërit dhe edukatorët

Fëmijët përballen me vdekjen në shtëpi, në shkollë dhe nëpërmjet medias. Ata mund të përjetojnë vdekjen e njërit prind, të gjyshit ose gjyshes, të motrës ose vëllait, apo të të tjerë anëtarëve të familjes. Fëmijët gëzojnë të drejtën të kuptojnë se si funksionon bota. Jeta, vdekja, lindja, sëmundjet, plakja dhe seksualiteti janë procese natyrore, për të cilat të rriturit duhet t'u thonë të vërtetën fëmijëve në mënyrë që ata të jenë të informuar dhe të përgatitur për të përballuar aspektet emocionale të këtyre proceseve. Vdekja është një temë e vështirë, e cila shpesh injorohet ose shmanget. Vdekja ka të bëjë me ndjenja negative si shqetësim, trishtim, zemëratë dhe frikë. Megjithatë, ajo mbetet pjesë e jetës së fëmijëve që nga vdekja e kafshëve shtëpiake e deri tek ajo e njerëzve më të dashur për ta. Të rriturit dëshirojnë ta shmangin vdekjen duke mos menduar për të. Mendimi i vdekjes për ta është shqetësues, sidomos kur u duhet t'ua shpjegojnë atë fëmijëve. Tek të rriturit, dëshira për ta shmangur temën e vdekjes buron nga nevoja për t'i mbrojtur fëmijët

ose nga besimi se fëmijët nuk janë në gjendje ta kuptojnë vdekjen dhe as ta përballojnë atë emocionalisht. Fëmijët e kuptojnë nëse u flitet dhe ndihmohen të shkarkojnë trishtimin, lëndimin dhe emocionet e tjera që vijna nga humbja.

Të rriturit t'u thonë të vërtetën e më pas t'i lejojnë fëmijët të pyesin e të përpiqen t'u përgjigjen pyetjeve të tyre në mënyrë të kujdesshme, por të sqartë. Fëmijët mund të pyesin, për shembull, se çfarë ndodh pasi dikush vdes. Pyetjet për vdekjen i shqetësojnë prindërit jo vetëm ngase mendojnë se vdekja është e frikshme për fëmijën, por edhe sepse mund edhe të mos kenë një përgjigje për pyetjet e tyre. Duke mos qenë vetë të sigurt për konceptin e vdekjes apo të jetës së përtejme, ata nuk duan që fëmijët ta kuptojnë këtë. Ngurrimi i të rriturve për t'u folur për vdekjen i çorodit fëmijët, ndaj dhe zgjidhja më e mirë është ndarja e mendimeve me ta. Kjo është pikërisht ajo që fëmijët dëshirojnë.

Pyetje për fëmijët

- Si e kalonin kohën Toni dhe Papi?
 - Si mendoni ju, pse koha kalonte pa u ndjerë kur Toni dhe Papi luanin bashkë?
 - Pse nuk i hëngri farat Papi?
 - Po ujin, pse nuk e piu dot?
 - Çfarë këshille i dha mjeku Tonit?
 - Pse u mërzi Toni?
- Si mendoni ju, pse nuk dëshironte Toni ta linte Papin të fluturonte?
 - Çfarë premtimi i bëri Toni Papit?
 - A e mbajti Toni premtimin?
 - Si e ndjeu Toni pranë Papin?
 - Kush e ndihmoi Tonin të mos dëshpërohej për largimin e Papit?
 - Si do te ndiheshit ju në vend të Tonit?

Babi, të dua shumë!

Kur babi i Arbi shkoi për të gjetur punë larg shtëpisë, madje edhe larg nga Shqipëria, vogëlushi sapo kishte filluar të belbëzonte: “ baba ... bab ... a...” Por ai ishte aq i vogël, sa fytyrën e babit nuk e mbante mend. Kur u bë një vjeç, u thoshte “babi” xhaxhait, dajës, kushërinjve që vinin në shtëpi. Mami, shpesh, merrte në dorë një foto dhe i thoshte:

- Zemra ime, ky është babi!

Mami puthte foton. E puthte edhe Arbi. Pastaj mami dhe Arbi përqafonin fort njëri-tjetrin. Dalëngadalë ai u rrit e u bë tre vjeç e gjysmë. Tashmë filloi ta kuptonte se babi i tij ishte larg, se çdo fëmijë kishte babanë e tij, i cili e donte, e përqafonte, e çonte në parkun e lodrave, luante me të. Vogëlushit i pëlqente të vizatonte. Vizatonte përnatë me mamin. Ai merrte fletë të bardha dhe lapsa me ngjyrë dhe sajonte kuaj, qenushë, lepurushë, mace e gjithfarë kafshësh, sepse ato i ka shumë xhan. Por më shumë se çdo gjë i pëlqente të vizatonte babin e vet, ashtu siç e shikonte në fotografi, dhe ashtu si mund të vizatojë një vogëlush si Arbi. Madje, iu lut mamin t’i mësonte shkronjat e fjalës “babi”. Dhe, zhgrapa-zhgrupa, e shkruante te të gjitha “fotot” e babit të tij, të cilat i ngjiste në murin e dhomës ku flinte. Ndërsa foton e vërtetë e mbante te komodinëza e vogël, pranë krevatit. Para se të flinte, e puthte plot dashuri e i pëshpëriste: “Natën e mirë, babushi im!”

Babi telefononte shpesh. Baba e bir nuk ngopeshin së foluri.

Një mbrëmje, kur Arbi po luante me mamin, u dëgjua zilja e telefonit. Arbi rendi si



një zog te telefoni. Ishte babi.

- Çfarë po bëje, vogëlushi im? - e pyeti babi.

- Po luaja me mamin. Ne luajmë dhe vizatojmë shumë. Kur të vish ti, ne do t'i bëjmë bashkë të gjitha këto, m i rë?

- Po si jo?! Unë mezi po pres.

- E di sa shumë do kënaqemi? Do qeshim, do tregojmë histori për shokët dhe kopshtin, edhe do të gatujmë!

Arbi fliste e qeshte. Qeshte edhe babi. Kur vogëlushi mbaroi, babi i tha:

- Shpirti im, tani të puth shumë. Natën e mirë dhe gjumë të ëmbël!

Arbi iu përgjigj:

- Babush, edhe unë, para se të fle, i them "Natën e mirë!" fotografisë sate dhe e puth. Por ... ah, sikur të më puthësh edhe ti, të më ledhatosh e të më tregosh përralla! ... Dua të shkojmë bashkë edhe në parkun e lodrave, si kalamajtë e tjerë... Babi, të dua shumë!

Një ditë babi u kthye përgjithmonë dhe Arbi u bë fëmija më i lumtur në botë.



Për prindërit dhe edukatorët

Gjatë jetës, fëmijët i krijojnë marrëdhëniet shoqërore mbi bazën e marrëdhënieve që kanë pasur me të rriturit në vegjëli. Fëmijët mësojnë të ndërtojnë mekanizma që zenë vend në psikikën e tyre duke parë dhe duke ndjekur modelet që u ofrohen në familje. Ata imitojnë sjelljet dhe mënyrën e komunikimit të prindërve të tyre, deri në detaje që syri i të rriturve ka humbur aftësinë t'i kapë.

Fëmijët kanë nevojë për të dy prindërit, pavarësisht arsyeve të forta që kanë të rriturit për të jetuar larg nga njëri-tjetri. Fëmijët ndjejnë dhe kuptojnë më shumë sesa mendojnë prindërit. Shprehje të tilla si: "Nuk e kupton, je i/e vogël." apo "Ta shpjegoj kur të rritesh." janë tregues të paaftësisë së të rriturve për të shpjeguar dhe jo i mungesës së aftësive të fëmijës për ta kuptuar. Fëmijët kuptojnë gjithçka, nëse gjendet gjuha e duhur për t'ua shpjeguar. Kur prindërit vendosin të jetojnë të ndarë, fëmijët, përveç faktit që u duhet të përballojë ndryshimet në familje, duhet të përballen edhe me injorimin e aftësisë së tyre për të kuptuar. Ata kanë shumë nevojë të flasin, të shkarkojnë atë që ndiejnë nga mungesa e figurës së njërin prind. Rrethanat ekonomike duket se kanë detyruar shumë prindër të marrin vendime që nuk janë të shëndetshme as për familjen e as për fëmijët.

Që të evitohen ndërlikimet në sjellje dhe emocione, fëmijët ndihmohen duke i lejuar të bëjnë pyetje për situatën. Mos u stresoni nga pyetjet e shumta; fëmijët kanë nevojë të kuptojnë, ndaj pyesin. Përgjigjuni thjesht dhe me qetësi, pasi nëse fëmija lexon ankthin, apo stresin tuaj, do të mësojë që tema për të cilën po flisni është e rrezikshme, e panatyrshme, apo e papërballueshme edhe për të rriturit. Po ashtu është e rëndësishme që fëmija t'i shprehin emocionet që ndiejnë. Sa më shumë emocione të pashkarkuara, aq më rrëmujë bëhet bota e tyre emocionale. Është e nevojshme për fëmijët që u mungon njëri prind të qajnë kur ndiejnë inat, trishtim, apo janë të mërzhitur.

Pyetje për fëmijët

- *Me kë jetonte Arbi?*
 - *Ku jetonte babi i Arbit?*
 - *Si ndihej Arbi që e kishte larg babin?*
 - *Çfarë bënte Arbi me mamën në darkë?*
 - *Çfarë mësoi Arbi të shkruante?*
- *Çfarë vizatonte Arbi?*
 - *Kush e mësoi Arbin të vizatonte?*
 - *Si mendoni ju se ndihet Arbi?*
 - *Po ta kishit ju shok Arbin, çfarë do të bënit?*

Sekreti i Trëndafilin të vogël

Na ishte njëherë një Trëndafil i vogël. Ai jetonte me prindërit në një shtëpizë buzë pyllit. Sa herë që prindërit shkonin në punë, e porosisnin djalin e tyre që të tregohej i kujdesshëm kur rrinte vetëm. Edhe atë ditë babi dhe mami trëndafilja u nisën për në punë duke i kujtuar porositë djalit të tyre.

Trëndafilin i vogël u premtoi se nuk do të harronte asnjë nga fjalët që i kishin thënë.

Pak minuta më vonë aty pranë kalon Grami, një burrë i hollë si një fije bari.

- Jam i lodhur dhe nuk kam ngrënë. A mund të zë një vend pranë shtëpisë sate? - i tha ai Trëndafilin të vogël.

Trëndafilin nuk u përgjigj. Grami vazhdoi t'i kërkonte që të rrinte aty.

- Unë mund të rri në këtë qoshe këtu, që ju nuk e përdorni. Kështu nuk do të më shohë askush. As prindërit e tu.

Trëndafilin përsëri nuk u përgjigj. Por Grami nuk hiqte dorë...

- Ky do të jetë sekreti ynë. Ke dëgjuar për sekrete ti? Të rriturit ruajnë gjithmonë sekrete. Edhe të vegjlit duhet të kenë sekretet e tyre, - i tha ai.

Trëndafilin i vogël mendoi se mund të mbante edhe ai një sekret. Ai e lejoi Gramin që të zinte vendin në qoshe të oborrit. Kur erdhën prindërit, ai nuk u tregoi për Gramin. Ditët kaluan dhe Grami u rrit sa hap e mbyll sytë. Fijet e tij u zgjatën dhe i zunë dritën shtëpisë. Ushqimi po mbaronte dhe lagështira po prishte muret. Trëndafilin të vogël i dukej sikur dikush i kishte varur gurë në petalet e vogla. Sa në faj ndihej teksa ruante brenda vetes sekretin! Të shqetësuar, prindërit dolën e vështruan



përreth dhe kur panë Gramin u mërzitën shumë. Pastaj me ndihmën e miqve të tyre ata e dëbuan atë derisa asnjë fije bari nuk mbeti rreth e rrotull shtëpisë. Kur hynë në shtëpi ata panë se Trëndafili i vogël rrinte kokulur.

- Çfarë ka ndodhur? - e pyetën djalin e tyre.

- Unë e dija për Gramin, - u tha ai, - por nuk ju tregova, sepse doja të kisha një sekret, si të rriturit. Por tani e kuptoj se po t'ju kisha treguar nuk do të ndihesha keq gjithë këtë kohë.

Prindërit e përqaftuan djalin e tyre. Teksa përqafoheshin, Trëndafili i vogël ndihej më i lehtësuar dhe më i sigurt pranë familjes së tij.

Për prindërit dhe edukatorët

Jo rrallë abuzimi i fëmijëve përfshin edhe detyrimin e tyre për të mbajtur sekrete. Zakonisht sekretet që u kërkohet të mbajnë fëmijëve janë probleme me pasoja të dëmshme për ta dhe/ose familjen e tyre. Fëmijëve mund t'u kërkohet të mbajnë sekret lojëra të dëmshme, prekje të papërshtatshme ose abuzime nga më të ndryshmet që, fëmijë më të rritur apo të tjerë persona, të njohur apo të panjohur, ushtrojnë mbi ta. Të tilla sekrete venë në rrezik sigurinë emocionale dhe fizike të fëmijëve. Fëmijët e moshës parashkollore është mirë të mos mbajnë asnjë sekret. Për ta, është ende herët të kuptojnë se cilat sekrete janë të sigurta për t'u mbajtur dhe cilat jo. Për këtë arsye, të rriturit nuk duhet të thonë në prani të tyre gjëra që nuk duan që fëmijët t'i dinë apo t'ua thonë të tjerëve. Fëmijët nuk duhen vendosur në pozitë të vështirë duke u kërkuar të gënjejnë për prindin apo të rritur të tjerë. Sekretet i bëjnë fëmijët të vuajnë. Të rriturit duhet të jenë të hapur të diskutojnë të gjitha çështjet me fëmijët, poa i gjykuar ata, vetëm kështu mund t'i ndihmojnë fëmijët që të flasin edhe për çështje delikate apo të vështira. Fëmijët e kuptojnë kur mund të gjykohen nga prindërit, ndaj heshtin. Kjo duhet shmangur.

Pyetje për fëmijët

- Si e porosisnin prindërit Trëndafilin e vogël?
 - Çfarë u premtoi Trëndafili i vogël prindërve?
 - Si mendoni ju, a duhet t'i dëgjojmë porositë e prindërve?
 - Pse i porosisin prindërit fëmijët të kenë kujdes kur janë vetëm?
 - Si mendoni ju, a duhen mbajtur premtimet?
 - Cili ishte sekreti i Trëndafilin të vogël?
- Pse nuk u tregoi ai prindërve për Gramin?
 - A ishte e lehtë për Trëndafilin e vogël të mbante një sekret?
 - Si ndihej Trëndafili i vogël teksa ruante sekretin e Gramit?
 - Pse rrinte kokulur Trëndafili i vogël?
 - Me kë do të flisnit nëse dikush ju kërkon të mbanit një sekret?

Vizatoni një sekret që keni mbajtur nga familja.

Kotelja Hiro dhe torta e maçokut Ziko

Koteles Hiro i pëlqenin shumë festat e datëlindjeve. Ato janë plot shokë e shoqe, plot lojëra dhe ëmbëlsira të mira, ashtu si datëlindja e maçokut Ziko. Kotelja Hiro kishte veshur fustanin më të bukur për këtë festë dhe fytyra i shkëlqente nga gëzimi. Ziko ishte miku i saj më i mirë. Edhe të tjerët ishin të gëzuar si Hiro. Rosaku i vogël kërcente me litar duke qeshur, ndërsa zogu pendëverdhë mbyllte sytë nga kënaqësia sa herë që çukiste ushqimet. Vetëm ketri Tik nuk dukej aspak i kënaqur. Përpiqej më kot të thyente një lajthi dhe, kur nuk ia doli, vari buzët nga mërzia. Sytë e koteles Hiro u ndalën te torta e datëlindjes. Ajo ishte zbukuruar me fruta plot ngjyra dhe në majë kishte një luleshtrydhe të kuqe dhe të madhe. Kotelja Hiro ndjeu dëshirën për të provuar pakëz nga torta. “Sa e mirë qenka!” - tha me vete Hiroja kur e provoi dhe u bë gati ta kafshonte përsëri. Në atë çast gjeli që ishte fryrë nga të mburrurit, u përplas me Hiron. Gjeli u rrëzua dhe sqepi i tij si gjilpërë shpoi tullumbacen e qengjit laraman. U dëgjua një zhurmë e fortë dhe të gjithë u trembën. Hiro pa lepurin që, duke u dridhur nga frika, u fsheh pas pemëve. Bretkosa Kuak u fsheh menjëherë në pellg dhe nuk lëshoi më asnjë britmë, ndërsa majmuni kërcëu drejt pemës, por u pengua te një çadër dhe ra mbi tortën e datëlindjes. Në mes të kopshtit mbetën vetëm Hiroja dhe Zikoja. Kotelja pa se shoku i saj kishte mbetur me sy dhe gojë hapur nga çudia. Pastaj buzët filluan t’i dridheshin dhe sytë iu mbushën me lot.

- Torta ime u prish. Si e bëre këtë, Hiro? - tha Ziko duke qarë.



Hiroja uli kokën dhe u largua. Gjatë gjithë rrugës kotelja nuk foli asnjë fjalë. Por kur hynë në shtëpi, ajo filloi të fliste me prindërit e saj për atë që kishte ndodhur në festë.

- Nuk desha ta prishja tortën e Zikos. Desha vetëm të provoja pak, se m'u duk shumë e mirë, - tha ajo.

- Ti e di që torta nuk provohet, derisa ai që ka datëlindjen ta ndajë me shokët dhe shoqet, - i tha babi Hiros.

- E pe sa u mërzit Zikoja? - tha mami.

Hiro nuk foli. I doli përpara syve fytyra e Zikos, e skuqur, gjithë lot dhe me buzët që i dridheshin. Pastaj iu kujtua datëlindja e saj dhe torta prej çokollate. Sa e kishte ruajtur që të mos e prekte askush derisa të gjithë të këndonin këngën e datëlindjes! Ndërsa ajo e kishte prekur tortën e Zikos dhe kishte krijuar gjithë atë rrëmujë. Të nesërmen ajo u zgjua më herët se zakonisht. I kërkoi mamit dhe babit që ta çonin në shtëpinë e Zikos. Kur u takua me Zikon, Hiro i kërkoi të falur. Maçoku hapi krahët për ta përqaftuar dhe ajo e kuptoi se ai e kishte falur. Të dy shokët luajtën e qeshën derisa dielli u var si një portokall i lumtur në qiell.

Për prindërit dhe edukatorët

Fëmijët i kuptojnë shumë mirë emocionet duke nisur që nga mosha 3 vjeçare. Kjo u lejon atyre të vlerësojnë ngjarje dhe situata të ndryshme, si dhe të përshtaten emocionalisht në kontekste shoqërore. Duke kuptuar emocionet e të tjerëve, fëmijët e kësaj moshe arrijnë të lexojnë mendjet e tyre. Sa më shumë njohuri të kenë fëmijët rreth emocioneve, aq më të aftë janë ta identifikojnë dhe ta interpretojnë informacionin emocional

të shprehur nga të tjerët dhe nga vetë ta, sipas kontekstit. Njohja dhe shprehja e emocioneve janë aftësi që fëmijët 3 vjeç e tutje janë të gatshëm t'i mësojnë. Megjithëse të aftë të parashikojnë emocionet që në moshën 3 vjeçare, aftësia e fëmijëve për të nxjerrë përfundime rreth emocioneve të të tjerëve mund të ndikohet nga ajo çka ata vetë dëshirojnë. Për të ndihmuar të kuptuarit e emocioneve, të rriturit duhet t'i edukojnë fëmijët me njohuritë e duhura dhe t'u mësojnë të flasin e t'i ndajnë emocionet me ta. Fëmijët i kuptojnë më mirë emocionet kur të rriturit u mësojnë t'i emërtojnë ato sesa kur u duhet t'i dallojnë vetëm prej shprehjes së fytyrës. Ndarja e emocioneve i ndihmon fëmijët të përballojnë gjendje emocionale të vështira dhe është një hap përpara drejt mësimit të mekanizmave të përballimit.

Pyetje për fëmijët

- Si mendoni ju, pse i shkëlqente fytyra koteles Hiro?
 - Pse ishin të gëzuar shokët dhe shoqet e maçokut Ziko?
 - Pse qeshte rosaku i vogël sa herë hidhej në litar?
 - Pse mbyllte sytë zogu pendëverdhë sa herë që çukiste ushqimet?
 - Si mendoni ju, pse nuk ishte i kënaqur ketri Tik?
 - Si e kuptuat ju që ketri Tik nuk ishte i kënaqur?
 - Pse u fsheh pas pemëve lepurit kur dëgjoi zhurmën e fortë të tollumbacit?
 - Po bretkosa Kuak pse u fsheh në pellg, pa lëshuar më asnjë britmë?
- Kush tjetër u tremb nga zhurma e tollumbacit?
 - Si ishte fytyra e Zikos pas rrëmujës?
 - Pse nisi të qajë Zikoja?
 - Si mendoni ju se u ndje Zikoja kur pa tortën e prishur?
 - A do t'ju pëlqente edhe juve të provonit tortën e datëlindjes së Zikos?
 - A do të kishit provuar dhe ju si Hiroja të hanit tortë pa u kënduar ende kënga e datëlindjes?
 - Si mendoni se u ndje Hiroja kur pa Zikon të mërzitur?
 - A mendoni se e kuptoi gabimin kotelja Hiro?

Harabeli dhe lepurushi

Lepurushi Belko po luante para shtëpizës së vet. Papritur, në mes të një kaçubeje vërejtí diçka të panjohur.

- A mos je zog ti? - e pyeti Belko me kureshtje.

- Po, jam një harabel i vogël! Kam dalë nga foleja dhe tani nuk di të kthehem në shtëpi - u përgjigj zogu duke qarë. - Po ti, mos je maçok? A do të më hash mua tani?

- pyeti i frikësuar harabeli.

Lepurushi Belko qeshi me zë dhe i tha se ai është vetëm një lepurush i vogël dhe paqësor, që quhet Belko dhe që, për ta mësuar harabeli i vogël, i shpjegoi se lepujt hanë vetëm barin e njomë, pemë dhe perime.

- O sa mirë, mua mami më tha të ruhem nga macet, - tha harabeli i lehtësuar. - Po çfarë bën këtu në tokë, pse nuk fluturon? - e pyeti Belko.

- Mua nuk më janë zhvilluar krahët si të gjithë zogjve të tjerë dhe nuk do të kem kurrë mundësi të fluturoj, - tha harabeli dhe uli kokën. - Prandaj edhe mami më ka porositur të mos largohem asnjëherë nga foleja, - pëshpëriti lehtë.

- Kjo do të jetë me të vërtetë shumë e vështirë për ty - tha Belko i menduar.

- Ashtu është, - tha harabeli - të shumtën e kohës unë jam vetëm, sepse mami del të kërkojë ushqim. Nuk kam as shokë ... - tha ai i mërzitur.

- Po çfarë bën kur rri vetëm? - pyeti Belko.

- Shoh lart qiellin dhe zogjtë që fluturojnë, sodis retë, yjet e ndonjëherë këndoj - tha harabeli. - Sot desha të provoj të fluturoj, që të shikoja pyllin, por jam rrëzuar e



prandaj kam humbur edhe rrugën.

- Mos u mërzit, - i tha Belko - unë mund të të ndihmoj ta shohësh pyllin. Edhe pse nuk mundesh të fluturosh, a mundesh të ecësh ngadalë ose të hipësh mbi kurrizin tim dhe së bashku të shëtisim nëpër pyll? Si thua?

- Kjo do të më pëlqente shumë, por më parë duhet të gjej mamin, sepse ajo do të jetë brengosur shumë për mua. - tha harabeli.

- Unë e di numrin e policisë së pyllit. Si thua, t'i thërrasim që të na ndihmojnë? - Oh, të lutem, bëje patjetër - tha harabeli.

Brenda pak minutash policia e pyllit mbërriti. Bashkë me ta ishte edhe mamaja harabele. Edhe ajo kishte kërkuar ndihmën e policisë kur nuk kishte mundur të gjente të voglin e saj. I gëzuar, harabeli shpejtoi drejt mamasë dhe u përqaftuan.

- Biri im, unë të kam thënë të mos ikësh nga foleja pa më treguar, mund të ishe lënduar.

- Më fal mami, - i tha harabeli - nuk do ta përsëris më.

Pastaj harabeli i tregoi mamasë për shokun e tij të ri, lepurushin Belko dhe për gjithçka tjetër që i kishte ndodhur.

- Faleminderit, i dashur lepurush, për kujdesin që ke treguar! - i tha mamaja harabele Belkos.

- Më vjen mirë që e ndihmova shokun tim të ri - tha Belko dhe pa mbaruar mirë fjalën shtoi:

- Teta harabele, unë dhe djali juaj kemi menduar të bëjmë një shëtitje nëpër pyll, nëse do të na jepni leje.

- Besoj se bëhet! - tha mamaja harabele - por tani është vonë dhe ne duhet të largohemi për në fole.

Ndërsa ngjitej mbi krahët e mamit, papritur e gjithë gëzim harabeli thirri: - Urraaaa, do të dalim shëtitje, faleminderit Belko, mirupafshim!

Belko i përshëndeti gjatë me dorë, deri sa u larguan. Pastaj u shtri mbi bar dhe pa qiellin pa re, me diellin që po perëndonte dhe zogjtë që shpejtonin në fole. Mendoi për shokun e tij të ri dhe tha plot gëzim:

- Nesër do të jetë një ditë e re, plot aventura për ne të dy!

Për prindërit dhe edukatorët

Empatia është aftësia për të kuptuar mendimet, ndjenjat ose emocionet e të tjerëve. Të qenit empatik/e ndaj dikujt do të thotë të kuptosh çfarë ndjen ai/ajo, duke e vënë veten në pozitën e tij/saj. Ne mund të hasim përgjigje empatike në situata të ndryshme emocionale, por empatia zakonisht përshkruhet si një përgjigje e kujdesshme dhe dashamirëse ndaj shqetësimit dhe dhimbjes së dikujt tjetër. Aftësia për të kuptuar se të tjerët kanë mendime dhe përjetime emocionale të ndryshme nga të tyret përftohet jo më parë se moshë 4 vjeçare. Para kësaj moshe, fëmijët mendojnë se gjithkush ka të njëjta mendime dhe ndjenja me ta, ndaj dhe janë të pavëmendshëm ndaj mendimeve dhe ndjenjave të pashprehura të të tjerëve. Edhe pse zhvillimi i empatisë te fëmijët varet nga një sërë faktorësh gjenetikë dhe mjedisorë, prindërit dhe edukatorët mbeten burimet kryesore të përvetësimit të kësaj aftësie.

Pyetje për fëmijët

- *Pse nuk fluturonte dot harabeli?*
 - *Si e kuptoi lepurushi Belko që harabeli nuk fluturonte dot?*
 - *Si e ndihmoi lepurushi Belko harabelin?*
 - *Si ndihej harabeli?*
 - *Po ju, a do ta ndihmonit harabelin të shihte pyllin?*
- *Po ju, a jeni larguar ndonjëherë nga shtëpia pa lejen e prindërve?*
 - *A keni humbur ndonjëherë?*
 - *Kush ju ka ndihmuar të ktheheni në shtëpi?*
 - *Si ndiheni nëse dikush qan?*
 - *Si ndiheni kur shihni që dikë po e shajnë?*
 - *Si ndiheni kur dikush vritet?*

Tori që e duan të gjithë

Tori është qeni i shtëpisë së një fshatari. Të gjitha kafshët e shpezët e asaj shtëpie e duan dhe kanë besim tek ai.

Pulat nuk kanë frikë nga dhelpira dinake, sepse e dinë se i ruan Tori. Qengjat tkullosin të qetë në livadh e nuk i tremben ujkut grabitqar, sepse e dinë që Tori nuk e lë të afrohet. E kështu, të gjithë me radhë, janë të qetë, kur qeni trim e besnik ndodhet pranë tyre.

Por një ditë Tori u gdhi i sëmurë. Dridhej nga ethet dhe teshtinte. Delja e mbuloi me një kuvertë, që sapo e kishte thurur me leshin e saj të butë dhe ai filloi të ndiente më ngrohtë.

- Të lumtë! - e përgëzuan delen kafshët e shpezët. - Ai na shërben përherë. Sot ne të gjithë duhet t' i shërbejmë atij! - vendosën ato.

- Mjalti ynë është ilaç i mrekullueshëm, - zhuzhitën bletët.

- Muuuu ... mu! ... Të sëmurët me grip duhet të pinë qumësht të ngrohtë, - ia bëri lopa. - Edhe vezët tona janë ushqim shumë i mirë, - kakarisën pulat.

Pulat sollën vezët. Patat i zien. Rosat i qëruan. Lopa bëri qumësht të freskët. Dhia i solli djathë. Bletët sollën një hoje dylli, mbushur plot me mjaltë. Macja e harroi mërinë dhe ia mbështolli qafën me një shall të butë, që vogëlushja e shtëpisë ia kishte shtruar mbi divan.

Të gjithë së bashku u mblodhën rreth Torit të sëmurë. Fillimisht e ndihmuan të hante vezët, të cilat gjeli i detit ia ndau copa-copa, sepse i dhembte fyti aq shumë, sa



nuk gëlltitej dot. Dy lepurushe e brejtën hojen e dyllit dhe mjaltin e verdhë si qelibari e përzien me qumështin e ngrohtë.

- Hau! ... hau! ... hau! - lehu i lumtur Tori. - Ju falënderoj nga zemra, miqtë e mi. Do të shërohem sa më shpejt dhe do t'ju ndodhem pranë ditë e natë.

- Ti pranë na ke qenë përherë, prandaj të duam kaq shumë! - iu përgjigjën ato.

Të nesërmen Tori u gdhi fare i shëruar. Kujdesi dhe dashuria e atyre që do dhe të duan është ilaçi më i mirë për trupin dhe për zemrën e kujtdo.

Për prindërit dhe edukatorët

Kjo përrallë shërben për të folur për të drejtat dhe përgjegjësitë e fëmijëve. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të rriten në familje. Bashkë me këtë të drejtë vijnë një sërë të drejtash të tjera dhe një sërë përgjegjësish. Të drejtat dhe përgjegjësitë, si çdo gjë tjetër, mësohen që herët në familje. Çdo fëmijë duhet të mësojë se cilat janë të drejtat dhe përgjegjësitë e tij/saj. Të drejtat u japin fëmijëve mundësinë të zhvillojnë dhe të përdorin tërësisht cilësitë njerëzore, inteligjencën, talentin dhe vetëdijen, si dhe të kënaqin kërkesat shpirtërore dhe nevojat e tjera. Të drejta janë ato që ne meritojmë t'i gëzojmë, pavarësisht se kush jemi e ku jetojmë. Disa nga të drejtat janë: e drejta për ushqim, e drejta për edukim, e drejta për shërbime shëndetësore, e drejta për të patur një emër, etj. Përgjegjësitë janë rolet që duhet të marrim në momente të caktuara që të respektojmë të drejtat e të tjerëve dhe të gëzojmë të drejtat tona. Disa nga përgjegjësitë janë: respektimi i të drejtave të tjerëve, të mësuarit sa më shumë, të zbatuarit e rregullave në familje, në shkollë, shoqëri, etj. Nëse ju doni t'i ndihmoni fëmijët të zhvillojnë vetëbesimin dhe t'u mësoni atyre disa përgjegjësi, atëherë nuk është asnjëherë vonë për të filluar.

Pyetje për fëmijët

- Kush është Tori?
- Çfarë i dhimbte Torit?
- Nga kush i ruan Tori pulat e shtëpisë?
- Po qengjat?
- Çfarë i ndodhi Torit?
- Çfarë bëri delja?
- Si u ndje Tori pas asaj që bëri delja?
- Po bletët?
- Për çfarë e ndihmoi mjalti Torin?
- Çfarë i solli lopa Torit?

- Po pulat?
- Po rosat si ndihmuan?
- Çfarë bëri dhia për Torin?
- Po macja që kish mëri, çfarë bëri?
- Si e ndihmuan lepujt Torin?
- Si u ndje Tori pasi të gjitha kafshët e ndihmuan?
- Cilat janë disa nga të drejtat tuaja?
- Çfarë përgjegjësish ke në familje? Për kë kujdesesh apo si i ndihmon të tjerët?

Vizato një të drejtë që ke.

Lotët e lules

Xhoi dhe Eni janë dy motërza të bukura e të mrekullueshme, si të gjithë ju. Vogëlushja Xhoi është pesë vjeç dhe shkon në kopsht. Eni është dy vjeç e gjysmë dhe shkon në çerdhe. Xhoi flet shumë mirë, ndërsa Eni ende i thotë fjalët gjysma-gjysma, por ama i kupton të gjitha dhe di ta shprehë atë që do. Dhe a e dini çfarë duan shumë të dyja vogëluset? Kafshët, lulet, diellin, hënën, detin, qiellin, ujet, madje edhe dëborën. Ato kanë shumë lodra e kafshë prej pelushi, por dëshira më e madhe ishte të kishin një kafshë të vërtetë, sidomos një qenush!

Dhe, një ditë të bukur prindërit i lumturuan duke sjellë në shtëpi një qenushe të vogël. Ajo duket si një plush lodër me qime të bardha, që fle në “krevatin” e vet, e mbuluar me një kuvertëzë të kuqe dhe që pi qumësht me biberon, si një bebe.

- Sa e bukul është Bola jonë! - rrahu doçkëzat Eni. Dhe qenushe i mbeti ky emër.

Pasditeve, sa kthehen në shtëpi, vogëluset e rrëmbejnë Borën në krahë, e përqafojnë, e ushqejnë, e nxjerrin në oborr për të “bërë çiqin” dhe lozin së bashku. Tani në shtëpinë e tyre ka më shumë gëzim, sikur të jenë tri fëmijë, sepse kafshët janë pjesëtarë të familjes.

Bora është një qenushe e ëmbël dhe ledhatare, por edhe trazovaçe e madhe. Ajo nuk lë gjë pa prekur e pa ngacmuar. Luan me pantoflat dhe i gris ato me dhëmbë, gërvisht mbulesat e kolltukëve, hidhet mbi krevate e zhubros kuvertat, hallakat nëpër shtëpi lodërzat e plushit, që i quan si shoqe të saj, dhe a i thua dot gjë? Të gjithë zbaviten me “bëmat” e saj.



Erdhi pranvera dhe në oborrin e shtëpisë kanë çelur lulet. Vogëlushet lumturohen sa herë çel një lule e re. Edhe Bora gëzohet, sipas mënyrës së saj prej qenusheje.

Një ditë ajo shkon te njëra lule dhe fillon të luajë duke ia goditur gjethet me putër.

- Obobo, ç'bën? - e qorton Eni - Nuk e di ti se lules i dhemb po ta lafësh "pam, pam"? - Ham ... ham ...! - ia bën Bora, duke tundur bishtin dhe hop këput një bisk me lule.

Aty ku u këput bisku, doli një pikëz uji, si lot. Ndërsa nga sytë e Enushit lotët riguan si rrëke:

- Bola, pse e bëre? Pse e këpute? ... U mërzita për lulen! Shikoje lulen e vogël si po qan!...

Në të vërtetë ato janë lotët e Enushes. Qenushja e shikon e habitur dhe nuk kupton gjë.

Por ne kuptuam shumë, apo jo?

Për prindërit dhe edukatorët

Kjo përrallë mund të përdoret si mundësi për të folur me fëmijët për natyrën, rëndësinë që ajo ka në mirëqenien tonë. Dashuria dhe kujdesi për natyrën vijnë natyralisht kur ne e njohim atë. Dashuria për natyrën vjen duke e njohur atë. Sa më shumë t'u flisni fëmijëve teksa shëtisni në parqe, liqene, për planetin në të cilin jetojmë, aq më shumë do i ndihmoni ta shohin mjedisin në të cilin jetojnë si pjesë të tyre. Këto informacione bëhen më të qendrueshme nëse u shpjegohen fëmijëve në natyrë, ose kur u lexoni ndonjë përrallë me dinosaurë dhe u shpjegoni se si janë dëmtuar kafshët dhe llojet e bimëve gjatë shekujve. Ambjentalistët flasin shpesh për një term kuptimplotë "edukimi ekologjik". Sipas tyre, ai nuk duhet të jetë i projektuar posaçërisht vetëm gjatë

shëtitjes në natyrë apo kur shohin kafshë. Edukimi ekologjik duhet të përfshihet dhe të ndërthuret edhe në bisedat në familje, në kopështe dhe në shkolla. Programet për rritjen e ndërgjegjes ekologjike janë në zhvillim edhe në vendin tonë. Kjo është një mundësi shumë e mirë, jo vetëm për njohjen e natyrës, por edhe për socializimin e fëmijëve. Për këtë është shumë e rëndësishme që ju vetë të jepni modelin tuaj.

Pyetje për fëmijët

- Sa motra ishin në përrallë?
 - Si quheshin ato?
 - Çfarë u blenë prindërit dhuratë?
 - Si quhej qenushi?
 - Si fliste Eni?
 - Çfarë bënin motrat me qenin?
- Përse u mërzit Eni?
 - Çfarë bëri Bora që Eni u mërzit?
 - Pse qau lulja?
 - Ti si kujdesesh për natyrën?
 - Çfarë do të doje të bëje për natyrën nëse do të kishe një shkop magjik?

Vajza më e pasur në botë

Dikur dhe diku, në një shtëpizë të vjetër prej balte, jetonte Yllka e vogël me prindërit e saj. Ata ishin shumë të varfër. Kishin vetëm një dhi dhe qenushkën Bora, e cila ishte shoqja e dashur e vogëlushes. Ajo nuk kishte asnjë lodër, asnjë shoqe tjetër. Yllka shikonte moshataret e pasura që kishin rroba të bukura e lodra gjithfarësh, por nuk e ftonin kurrë të luanin së bashku. Madje një ditë, njëra prej tyre tha:

- Shikojeni si na i ka ngulur sytë ajo varfanjakja!

Ato ia plasën gazit dhe e përqeshën.

Vogëlushja rendi në pyll, u ul pranë një gëmushë dhe qau shumë. U mërzit shumë që moshataret e saj e tallën. Ajo ndihej e lënduar.

Pas një copë here filloi shiu. Gëmusha përkuli degëzat si ombrellëz dhe i foli ëmbëlsisht:

- Vogëlushe, futu nën degëzat e mia!

Yllka e falënderoi dhe u struk poshtë saj.

Pas pak, te gëmusha u ndal një lepurush. Kur pa Yllkën, u mat të ikte.

- Eja, eja! - i thirri ajo - ka vend edhe për ty.

Pas lepurushit ia behu një fazan. Yllka i bëri vend edhe atij. Të tre u strukën pas njëri-tjetrit. Kur rrebeshi u bë edhe më i fortë, u afrua një kaproll i vogël, që dridhej nga të ftohtit. Yllka nxori gjysmën e trupit jashtë gëmushës dhe e futi brenda. Pas kaprollit arriti një arush i vogël topolak.



- Eja, bebush i gjorë! - i tha Yllka dhe doli vetë përjashta.

- Vogëlushe, ti e paske zemrën më të madhe se unë, - i tha gëmusha me admirim.

- Kjo qenka vajza më e mirë në botë! - u çudit shiu - Si mund ta lag unë atë? - dhe u ndal.

- Ti e paske zemrën më të artë se unë, - buzëqeshi dielli dhe hodhi rrezet e ndritura. Kafshëzat falënderuan gëmushën, pastaj rrethuan Yllkën plot dashuri.

- Pse nuk rri me ne në pyll? - i thanë - Ne të gjithë jemi jetimë, rritemi së bashku. Prindërit tanë na i kanë vrrarë gjahtarët. Do të jesh motra jonë. Yllka i përqafoi e i ledhatoi të gjithë.

- Vogëlushë të dashur - u përgjigj ajo - nuk mund të rri, sepse prindërit e mi do të mërzhiten shumë ... Ejani ju në shtëpinë time!

Kafshët, të gëzuara, e ndoqën pas... Tashmë Yllka, përveç dhisë dhe qenushes Bora, kishte edhe katër miq të tjerë. Ajo luante e gëzohej me ta dhe nuk e ndiente më as vetminë dhe as përbuzjen e moshatareve të pasura. Ato ndaleshin përtej gardhit të shtëpisë së varfër dhe e vështronin. Vërtet kishin shumë lodra të bukura e të shtrenjta, por asnjëra



nuk krahasohej me kafshëzat e Yllkës.

Një ditë, teksa vajzat po e shihnin me zili, puhiza fluturoi mbi kryet e tyre dhe u pëshpëriti:

- Ju mburreni se jeni të pasura? Jo, jo, jo! Yllka është vajza më e pasur në botë. Ajo vërtet nuk ka shtëpi të re, rroba të bukura dhe lodra të shtrenjta. Por ka një zemër të mirë e të madhe, që nuk e keni asnjëra nga ju. Zemra është pasuria më e vyer e njeriut. E vetmja pasuri që nuk e humbim kurrë.

Vajzat e pasura ulën kryet të turpëruara për sjelljen e tyre ndaj Yllkës. Ato e kuptuan gabimin dhe i kërkuan falje asaj. Vogëlushja u buzëqeshi dhe i ftoi të luanin me “lodërzat” e saj, kafshët e vogla, miqtë e dashur e të mrekullueshëm.

Për prindërit dhe edukatorët

Kjo përrallë ndihmon të flitet për disa marrëdhënie mes fëmijëve të cilat mund të lenë gjurmë në jetën e tyre. Në moshën 3-6 vjeç marrëdhënia me tjetrin është ende një marrëdhënie shumë konkrete dhe elementare. Nëpërmjet të tjerëve, fëmijët mësojnë të rriten dhe të përshtaten. Fëmijët mund të kenë vështirësi në krijimin e miqësive për arsye të ndryshme, si: konkurrenca, mungesa e dëshirës për të ndarë gjërat, lodrat, etj., mungesa e përvojës për të luajtur me fëmijë të tjerë (siç mund të ketë raste të fëmijëve të vetëm, pa motra/vëllezër), mungesa e vetëbesimit apo mospasja e një hobi, pamundësia për t'u shkëputur, mungesa e elasticitetit për të kaluar nga njëra lojë te tjetra, stereotipitë, etj.

Fëmijët në moshën parashkollore janë nga natyra egocentrikë (të përqendruar te vetja). Ata kanë nevojë të ndihmohen të mësojnë të ndajnë gjërat e tyre me të tjerët, të pranojnë tjetrin/ën për atë që është, të mësohen me të ndryshmit. Fëmija vetë është i ndryshëm edhe mes të barabartëve.

Pyetje për fëmijët

- Me kë jetonte Yllka?
 - Si quhej qeni i saj?
 - Si vishej Yllka?
 - Po shoqet e saj?
 - Çfarë thanë shoqet e Yllkës për të?
 - Si reagoi Yllka?
 - Ku u fsheh Yllka?
 - Çfarë ndodhi kur u fsheh nën gëmushë?
 - Kush erdhi te vendi ku ishte futur Yllka?
 - Si i priti Yllka lepurin, arushin topolak dhe fazanin?
 - Çfarë i tha gëmusha Yllkës?
 - Po shiu?
-
- Çfarë i kërkuan kafshët e pyllit Yllkës?
 - Përse donin ata që Yllka të rrinte me ta?
 - Po Yllka, si u përgjigj?
 - Me çfarë luante Yllka në oborrin e shtëpisë së saj?
 - Çfarë u tha puhiza vajzave të pasura?
 - Si u ndjenë ato?
 - Si reagoi Yllka?
 - Çfarë mendoni për Yllkën?
 - Po për shoqet e saj?
 - Si do të kishit reaguar ju po të ishit në vendin e Yllkës?
 - Po në vendin e shoqeve të saj?

Panairi i verës

Ferma e akullores ndodhet në një kodër mes pemësh. Sa herë që nis vapa, ferma mbushet plot me kafshë që nuk ngopen së ngrëni akullore me shije të ndryshme. Edhe mama drenusha sjell drerët e vegjël për të ngrënë akullore. Por këtë herë ajo erdhi bashkë me vogëlushet e saj për të marrë pjesë në panairin e verës. Dy drerët, vëlla e motër, kishin përgatitur reçel me frutat e pyllit. Ata kishin mbledhur një nga një frutat dhe, pasi i kishin larë e pastruar mirë e mirë, kishin përgatitur reçelin siç ua kishte mësuar gjyshja. Drerët e pëlqenin shumë panairin e verës. Gjithë vitin ata nuk bënë gjë tjetër veçse mendonin se me çfarë ushqimi do të merrnin pjesë dhe ndiheshin aq të lumtur kur gjithçka shkonte mirë.

- Keni bërë një reçel shumë të shijshëm, - thanë ketrat duke lëpirë buzët nga kënaqësia.

Derrkuci më i vogël i fermës i kishte ngulur këmbët fort në tokë vetëm e vetëm që të zinte vendin qendror në tavolinën e drerëve dhe të shijonte reçelin me fruta pylli.

- Dua reçel edhe unë!- thoshte derrkuci. - Ky është reçeli më i mirë në botë!

Drerëve u shkëlqeu fytyra nga gëzimi. Teksa shërbenin reçelin e tyre, ata menduan se do të ishte shumë bukur sikur të kalonin edhe te tryezat e tjera për të provuar ushqimet. Lopa Mumu kishte bërë një djathë për të cilin drenushat e uruan.

- Të lumshin duart, Mumu!

E lumtur, Mumuja u dha edhe nga një gotë qumësht, të cilën drerët e pinë me një frymë. Më tej pula Koko kishte radhitur vezët e saj të mëdha dhe po mundohej të



Reçel nga drerët

PANAIRI I VERËS

gatuante disa prej tyre. Drenushat provuan pak bukë me vezë dhe e uruan pulën për vezët e freskëta. Familja e lepujve kishte sjellë perimet e kopshtit: karota, lakra dhe sallatë. Të gjithë u mahnitën nga ushqimet plot lëng. Madje supa me karota, që baba lepuri kishte gatuar, ishte duke mbaruar, ngaqë të gjithë donin të hanin.

- Është shumë e shijshme! Ju lumshin duart për punën kaq të mirë që keni bërë!
- u thoshin të gjithë.

Duke provuar ushqimet nga një tryezë në tjetrën, kishte kaluar e gjithë dita. Teksa dielli ishte duke u ulur mbi lëndinë, mama dhia dhe kecat u dhanë akulloret më të mira të fermës. Maçokët dhe qenushët u sulën të parët për të rrëmbyer kaushët me akullore dhe çokollata. Të tjerët pritën radhën me padurim, ngaqë e dinin se ato ishin akulloret më të shijshme të verës. Në fund, kecat kënduan një këngë dhe pastaj të gjithë filluan të kërcenin dorë për dorë.

Për prindërit dhe edukatorët

Kjo përrallë ndihmon të kuptojmë rëndësinë e miqësive, respektin, vlerësimin dhe mbështetjen për shokun/ shoqen. Fëmijët e moshës parashkollore, duke nisur nga 3 deri në 5 vjeç, flasin qartë dhe hapur për miqtë e tyre. Ata e dallojnë miqësinë si një marrëdhënie të veçantë, të ndryshme nga të tjerat. Për ta, miqësia ze vend më të rëndësishëm se për fëmijët deri në 2 vjeç. Pothuajse të gjithë fëmijët e moshës parashkollore kanë miq dhe i vlerësojnë shumë ata. Në këtë moshë, miqësia ka të bëjë kryesisht me lojën. Pritshmëritë e fëmijëve në moshën parashkollore nuk janë aq të pjekura apo komplekse sa të fëmijëve më të rritur. Parashkollorët fokusohen kryesisht në ndarjen e interesave dhe të aktiviteteve të përbashkëta. Shokët/shoqet për ta janë

njerëzit me të cilët kënaqen duke luajtur dhe që pëlqejnë të njëjtat lojëra. Zgjedhja e miqve varet nga loja dhe ngjashmëria në parapëlqime. Miqësia u mundëson fëmijëve të kësaj moshe të testojnë sjellje dhe emocione të ndryshme në lojë.

Pyetje për fëmijët

- A keni shkuar ndonjëherë në panair?
 - Nëse po, a ju ka pëlqyer?
 - Si mendoni ju, pse e prisnin me padurim panairin e verës drerët?
 - A mendoni se po kënaqeshin kafshët në panairin e verës?
 - Nëse po, pse?
 - Pse po prisnin në radhë kafshët?
 - Po ju, a e respektoni radhën?
- Po ju, a i uroni shokët dhe shoqet kur ndajnë ushqimet, lodrat apo librat me ju?
 - A ju pëlqen t'i uroni miqtë, prindërit apo njerëz të tjerë?
 - Cilat urime njihni?
 - Cilat urime përdorni më shpesh?
 - Kush është shoqja apo shoku yt më i ngushtë?
 - Çfarë bëni bashkë?
 - Çfarë të pëlqen shumë tek ai/ajo?

Genti bën gol!

Genti është dy vjet më i vogël se vëllai i tij Eno. Meqë është më i madh, Eno mendon se ka të drejtë të bëjë çdo gjë, të ketë çdo gjë dhe të sillet si të dojë me vëllanë e vogël.

Sapo Genti merr një lodër, Eno ia rrëmben nga dora:

- Këtë lodër ma ka blerë babi, kur isha më i vogël.

Genti ul kokën, lë lodrën dhe ... bën të ndezë televizorin, por Eno hidhet:

- Tani do të shoh unë. Po të duash ulu e shiko ç'të dua unë; po nuk deshe, mbathja!

Genti psherëtin, shkon te rafti i librave dhe, sapo bëhet gati të zgjedhë, Eno turrent: - Mos guxo të m'i prekësh librat as me gisht!

Genti nuk guxon të marrë as lapsat për të vizatuar, as gërshërët e letrave të punëdores, asgjë ... asgjë! Sa herë i vëllai i gërthet, ai gëlltit lotët që janë gati t'i rigojnë në faqkat topolake. Eno sillet kështu kur prindërit nuk janë në shtëpi, se përndryshe...

Kur Eno luan futboll me shokët në oborrin e pallatit, del edhe Genti. Kalamajtë e ftojnë të luajë me ta, por Genti ul kokën dhe hesht. Ata përpiqen ta bindin, por vogëlushi, ndonëse ka shumë dëshirë të luajë, e di se Eno do ta turpërojë përpara të gjithëve e do t'i thotë si e ka zakon: "Ik, se nuk merr vesh ti!"

Në të vërtetë, është Eno ai që nuk ia shkrep për këtë lojë. Nuk bën kurrë asnjë gol, madje, kur e vënë portier, ha gola sa shqepet e tërë skuadra.

Një ditë mungonte Ledio. Kalamajtë e ftuan përsëri në lojë Gentin, që ta



zëvendësonte. - Genti është i vogël, nuk di të luajë - kundërshtoi Eno.

- Nuk ka gjë, të gjithë kanë të drejtë të luajnë. Edhe nëse nuk di, do të mësojë - tha kapiteni i skuadrës.

Filloi loja. Genti sullej me guxim dhe shkathtësi që i habiti të gjithë. Eno, që ishte portier, i hëngri dy gola. Por lojtarët e skuadrës arritën të bënin barazim. Po mbaronte loja. Secila skuadër donte të arrinte fitoren. Genti gjeti çastin, u turr befas në fushën tjetër dhe... - Gooooo! - brohoritjet nuk kishin të sosur.

Lojtarët e ngritën në krahë, duke thirrur: "Genti! ... Genti!" ...



Dashamirësia dhe besimi i fëmijëve e bëri vogëlushin të ndihet njësoj si të tjerët, por e mësoi edhe Enon të sillet me të vëllanë ashtu si duhet të sillemi me më të vegjlit e më të dobëtit.

Për prindërit dhe edukatorët

Kjo përrallë ndihmon të flasim për marrëdhënien mes motrave dhe vëllzërve. Ata duhen, por natyrisht që grinden. Është pjesë normale e rritjes dhe familjes. Zënkat janë normale dhe të shëndetshme për fëmijët, sidomos ato mes vëllzërve e motrave. Kjo është mënyra se si ata mësojnë të bashkëpunojnë, të ndihmojnë njëri-tjetrin, të zgjidhin konfliktet apo të bëhen të pavarur. Ndërhyrjet “për të vendosur drejtësi” nga ana e të rriturve vetëm shton zemërmin e fëmijëve dhe thellon hendekun mes tyre. Fëmijët janë në gjendje t’i japin zgjidhje situatave edhe konfliktuale. Kanë nevojë t’u jepet hapësira për t’i zbatuar këto aftësi. Sa më shumë të lejohen fëmijet t’i zgjidhin vetë disa çështje të tyre, aq më të zotët bëhen për të përballur sfidat kur të rriten.

Pyetje për fëmijët

- Çfarë bënte Enoja?
 - Si ndihej Genti?
 - Çfarë thoshte Enoja kur Genti merrte ndonjë lodër?
 - Po kur Genti shkonte tek rafti i librave?
 - Si reagonte Enoja kur Genti donte të shihte televizor?
 - Si ju duken reagimet e Enos?
 - A jeni ndjerë ndonjëherë si Enoja?
 - Po si Genti?
- Çfarë ndodhte në lagje?
 - A e ftonin shokët Gentin të luante?
 - Si reagonte Genti?
 - Çfarë ndodhi që Genti u fut në lojë?
 - Si luajti ai?
 - Sa gola nuk prititi Eno?
 - Po të ishit shoku i Gentit dhe i Enos, çfarë do të kishit thënë?
 - Kush e ndihmoi Gentin?

Festat tona

- Mami, mami, shiko çfarë dhuratë kam marrë te Borisi. Ma dha nëna e tij Branka
- tha Saimiri duke hyrë në shtëpi. Në dorë kishte një vezë të kuqe. - Na ka gositur
me ëmbëlsira. Në tryezën e tyre kishte shumë lloje.

- Sa bukur, - i tha mami - sa interesant qenka e ngjyrosur ajo vezë. A e falënderove
teta Brankën?

- E falënderova! Por edhe unë dua. Dua të kemi në shtëpinë tonë vezë të ngjyrosura
- nuk pushonte Saimiri.

- Po mirë, biri im, unë do të ngjyros një vezë për ty.

- Nuk dua një, por shumë dhe me ngjyra të ndryshme. Përse të mos bëjmë edhe
ne vezë plot ngjyra dhe vizatime? Te Borisi ka shumë, është e mbushur shporta mbi
tavolinë. Mami u mendua dhe e mori Saimirin në prehër.

- Biri im, ata sot kanë festë në shtëpinë e tyre. Dhe për këtë festë ngjyrosen vezët
dhe gatohen ëmbëlsira.

- Përse të mos e bëjmë edhe ne këtë festë? - pyeti Saimiri.

- Sepse ne kemi festën tonë. A të kujtohet kur na vijnë mysafirë dhe kur ti merr
dhurata? A të kujtohet sa ëmbëlsira gatuj unë? E mban mend Borisin sa herë kënaqet
kur provon ëmbëlsirat dhe merr dhurata këtu te ne?

- Ehe... por edhe dhuratat e Vitit të Ri Borisi i merr disa ditë më përpara, ndërsa
unë vetëm në ditën e fundit. Përse kështu? - pyeti i çuditur Saimiri.

- Sepse festat tona ndryshojnë - iu përgjigj mami.



- Por ato të gjitha janë festa, apo jo mami?

- Ashtu është. Të gjithë festojnë sipas mënyrës së tyre, siç kanë festuar prindërit dhe gjyshërit e tyre për një kohë shumë të gjatë. Festat dhe gëzimet e shokëve tanë, fqinjëve dhe miqve, janë ditë të bukura kur ne ndajmë bashkë ushqime dhe dhurata dhe urojmë të jemi gjithmonë të gëzuar. Ne duhet të tregohemi të sjellshëm me festat e njëri-tjetrit, sepse jetojmë së bashku në një vend.

Për prindërit dhe edukatorët

Kjo përrallë krijon hapësirën për të folur për ndryshimet kulturore apo fetare që kanë familje të ndryshme. Dallimet kulturore përfshijnë dallimet fetare, etnike dhe ato kulturore të grupeve të ndryshme shoqërore. Jo rrallë këto dallime bëhen shkak për mosmarrëveshje dhe keqkuptime. Si fillim, edukatorët dhe prindërit duhet të jenë të hapur të kuptojnë botëkuptimin e njëri-tjetrit, përfshi besimet, vlerat dhe normat kulturore, fetare, etnike, etj. Të kuptuarit e këtyre dallimeve lehtëson gjetjen e një zgjidhjeje të përbashkët, në dobi të rritjes dhe të edukimit të shëndetshëm të fëmijëve. Informacioni kulturor i ndihmon edukatorët të kuptojnë mënyrën e rritjes së fëmijëve në familje. Me anë të këtij informacioni, ato jo vetëm i kuptojnë më mirë sjelljet e fëmijëve dhe të prindërve, por edhe janë në gjendje t'i edukojnë fëmijët pa rënë në kundërshtim me praktikat kulturore të familjes. Këto praktika mund të përfshijnë besime të ndryshme fetare, si për shembull besimin në Zot, mënyrën e organizimit të festave të ndryshme dhe ritualet përkatëse, përgatitjen e ushqimeve ose të dhuratave të ndryshme sipas festave të caktuara, etj.

Pyetje për fëmijët

- Si mendoni ju, pse ishte i entuziazmuar Samiri?
 - Çfarë mbante në dorë ai?
 - Ku kishte qenë Samiri atë ditë?
 - Çfarë i kishte mbetur atij në mendje?
 - Çfarë i kërkoi Samiri mamit?
- Si u përgjigj mami?
 - Çfarë i shpjegoi ajo Samirit?
 - Cilat festa festoni ju në familje?
 - Çfarë bëni me rastin e këtyre festave?

Shëtitje me Tafi

Tafi bën shumë pyetje. Sa herë që del me prindërit apo me motrat dhe vëllezërit i pëlqen të pyesë për çdo gjë.

- Çfarë bën arusha në mes të rrugës me tabelë në dorë? - pyeti Tafi mamin e vet.

- Ajo është një police dhe kontrollon trafikun në rrugë, - tha mami.

Në atë çast arusha police ngriti tabelën e kuqe dhe biçikletat ndaluan. Tafi me mamin dhe dy lepurusha kaluan në anën tjetër të rrugës. Ata u futën në mes të një lulishteje shumë të bukur dhe u ulën në një stol. Tafi filloi të luante. Ai pa lulet e bukura dhe mendoi sa mirë do të ishte sikur t'i dhuronte mamin një lule të bardhë. U afrua që të këpuste një lule për mamin, por, sapo u bë gati ta merrte lulen më të bukur, dëgjoi një zë:

- Mos i këput lulet!

Tafi ktheu kokën. Qenushi lulishtar po e vështronte me qortim.

- Vetëm një! - iu lut Tafi.

Por qenushi nuk pranoi. Ai i tregoi Tafit sa shumë punë duhet që një lule të bëhet aq e bukur. Por Tafi përsëri mendonte se lulishtari mund ta kishte lejuar të këpuste një lule të vetme. Si mund ta gjente një për mamin? Teksa mendonte kështu nuk e pa fare gurin që kishte përpara dhe u rrëzua. Nga gjuri filloi t'i rridhte gjak. Qenushi vrapoi për ta ndihmuar dhe e çoi deri te stoli ku mami breshka po lexonte një libër. Mami e çoi në ambulancë për t'i mjekuar këmbën. Një rosë me përparëse të bardhë



i fshiu gjakun, i vuri ilaç dhe ia lidhi këmbën.

- Si quhet puna jote? - pyeti Tafi.

Rosa i shpjegoi se ishte një infermiere dhe ndihmonte mjekun për të shëruar ata që sëmuren apo që vriten kur luajnë.

- Po atë lule të bardhë ku e ke gjetur?

- E kam blerë, - iu përgjigj rosa.

Gjatë gjithë rrugës për në shtëpi Tafi e kishte mendjen te lulja e bukur që nuk kishte mundur ta gjente. Përse ai qenushi nuk e kishte lënë të merrte vetëm një lule?!

Papritur ra dera. Një kangur postier pyeti mami breshkën:

- Më falni, kjo është shtëpia e Tafit?

Breshka pohoi me kokë.

- Kam një porosi nga lulishtari i qytetit.

Tafi që kishte dëgjuar fjalët e fundit të kangurit u shfaq menjëherë në derë. Kur pa vetëm një kuti në duart e kangurit u bë gati për të ikur, por mami breshka i tha:

- Përse nuk e hap?

Tafi e hapi kutinë. Sa shumë u çudit kur pa aty brenda një vazo me lulen e bardhë! Mami i lexoi shënimin e qenushit: "Kjo lule është për ty. Kujdesu dhe mos harro: Lulet nuk këputen!"

Për prindërit dhe edukatorët

Kjo përrallë flet për përkatësinë në komunitet. Përkatësia në komunitet nënkupton formimin e marrëdhënieve të sigurtas ose të një lidhjeje të qëndrueshme me një grup njerëzish në veçanti ose me pjesëtarët e komunitetit në përgjithësi. Ajo krijon te fëmijët që në moshë të hershme ndjesinë pozitive për veten, të tjerët dhe mjedisin ku jetojnë. Përkatësia në komunitet i lejon ata të ndihen të vlerësuar dhe të respektuar, pjesë e komunitetit. Marrëdhëniet me pjesëtarët e familjes, të rriturit dhe fëmijët e tjerë, miqtë dhe pjesëtarët e komunitetit luajnë rol kyç në ndërtimin e identitetit. Të kuptuarit e vetes formësohet prej tipareve, sjelljeve dhe kuptimeve që fëmijët i veshin vetes, familjes së tyre dhe komunitetit ku jetojnë. Përkatësia në komunitet zhvillohet duke i ekspozuar fëmijët ndaj pjesëtarëve të komunitetit, roleve dhe kontributeve të tyre, si dhe mënyrës së funksionimit të komunitetit.

Pyetje për fëmijët

- Çfarë i pëlqen të bëjë Tafi?
 - Po juve, a ju pëlqen të bëni pyetje?
 - Çfarë po bënte arusha në mes të rrugës?
 - Çfarë mbante ajo në dorë?
 - Pse u mërzi Tafi?
 - Pse nuk e lejoi qenushi lulishtar Tafi të këpuste lulen?
- Kush ia mjekoi këmbën Tafi?
 - Po ju, a keni shkuar ndonjëherë në ambulancë?
 - Çfarë pune bënte rosa infermiere?
 - Çfarë i solli Tafi kanguri postier?
 - Po ju, a keni marrë ndonjëherë ndonjë dhuratë?
 - A mendoni se e kuptoi gabimin Tafi?

Gjigandi dhe topi

- Përse dridhet toka? - pyeti prindërit Toni, një djalë i vogël që ishte trembur natën e kaluar. Dhoma e tij ishte tundur nga tërmeti. Sa ishte frikësuar ai!

- Ndoshta ka ftohtë. - u përgjigj babi - Do të ketë harruar të veshë pallton.

Babi filloi të imitonte një njeri që ka shumë ftohtë duke kapur trupin me duart sikur të donte të ngrohej.

- Oh sa ftohtë! Po dridhem! - tha babi duke kërcitur gjoja dhëmbët.

Tonit iu duk sikur kërcitën dollapët. Vështroi nga prindërit. Ata ishin duke qeshur me njëri-tjetrin dhe po bënë garë se kush kishte më ftohtë nga të dy. Toni iu bashkua lojës së tyre.

- Po ti mami si thua ... përse dridhet toka? - e pyeti ai.

Mami u mendua pak dhe tha:

- Unë mendoj se një pjesë e formueses nuk ka gjetur vendin e vet. Ajo mendon se duhet të rrijë aty, por vendi është më i vogël. Kështu që po shtyn pjesët e tjera që të futet në pazëll.

Mami filloi të shtynte më bërryla në ajër, sikur të ishte një copë pazlli që nuk po gjente rehat. Bërrylat e saj prekën babin dhe Tonin. Atij iu duk sikur u drodh dhe u frikësua. Vështroi mamin dhe babin dhe kuptoi se ishin vetëm lëvizjet e tyre.

Tani ishte radha e tij për të dhënë përgjigjen. Toni mbylli sytë dhe kujtoi natën e tërmetit. Ai kishte qenë në gjumë dhe ishte zgjuar nga zhurmat e librave që kishin rënë në tokë. E gjithë dhoma e tij dridhej. Edhe krevati. I frikësuar ai kishte mbuluar



kokën me jastëk. Në fillim kishte menduar se një gjigand po ecte pranë shtëpisë së tij. Por, kur dridhjet kishin vazhduar e kishte harruar fare gjigandin dhe ishte trembur akoma më shumë.

- Edhe ne u trembëm – i tha mami.
- Çfarë po bënte gjigandi? - e pyeti babi.
- Po kërkonte topin që i kishte humbur - u përgjigj Toni.

Të tre u ngritën në këmbë dhe filluan të kërkonin topin nëpër dhomë. Toni, mami dhe babi po i përplasnin këmbët fort në dysheme duke imituar gjigandin kur dhoma filloi të dridhej. Tonit i ngriu këmba në ajër. Prindërit e morën djalin përdore dhe të tre u futën poshtë tavolinës, duke u kapur pas këmbëve të saj. Kur dridhjet pushuan babi vazhdoi lojën që kishin nisur:

- Toni, gjigandi yt nuk e paska gjetur akoma topin.. - i tha ai djalit.
- Kush? - pyeti Toni që e kishte harruar fare gjigandin nga frika e tërmetit.

Kur pa se prindërit e tij ishin të qetë, ai filloi të luante sërish. Mbylli sytë dhe mendoi se ku mund të ishte vallë topi i gjigandit.

- Ah, sikur t'ia gjeja topin - tha Toni - atëherë toka nuk do të dridhej më.
- Ai do të luajë ndonjë ditë tjetër dhe mund ta humbë përsëri topin - shtoi mami.
- Unë u tremba shumë - u ankua Toni dhe sytë gati po i mbusheshin me lot.
- Edhe ne u trembëm - tha babi.

Toni i pyeti prindërit se çfarë mund të bënin kur gjigandi do të kërkonte topin e humbur.

- Mënyra më e mirë është që të mësojmë rregullat sesi duhet të ruhem kur ai na

shkund shtëpinë, apo dyqanin, apo kopshtin apo rrugën ku ndodhemi.

Gjithë atë pasdite, Toni bashkë me prindërit mësoi rregullat për të ruajtur veten nga dridhjet e gjigandit. Ai e kishte akoma pak frikë, por tani që e dinte se çfarë duhet të bënte ndihej më i qetë.

Për prindërit dhe edukatorët

Kjo përrallë tregon nevojën që fëmijët kanë për të kuptuar fenomene natyrore si tërmeti. Tërmetet janë të paparashikueshme dhe natyrisht krijojnë shumë frikë edhe tek të rriturit, kjo është normale. Fëmijët kanë burim sigurie dhe informacioni prindërit. Kur ata shohin të rriturit shumë të frikësuar dhe pa shprehitë e nevojshme për të reaguar në këto rrethana tremben dhe kjo trembje aktivizon frikërat e tjera të fëmijës. Fëmijët kanë nevojë të ndihmohen të kuptojnë atë që po ndodh, por mbi të gjitha kanë nevojë të kuptojnë si duhet të reagojnë në mënyrë të përshtatshme në situata të tilla. Shpjegimet bëhen duke i kryer me fëmijët sjelljet dhe jo vetëm duke ua treguar me fjalë. Kur ju i bëni me ta, ata e kuptojnë më mirë dhe ndihen më të sigurtë që e kuptuan drejt atë që duhet të bëjnë. E rëndësishme është që ata të kuptojnë që ju jeni me ta dhe në çfarëdo situatash do i ndihmoni dhe mbron.

Pyetje për fëmijët

- Përse kishte frikë Toni?
 - Çfarë i tha babi për tokën?
 - Po mami i Tonit çfarë tha për tokën?
 - Çfarë bënte gjigandi që tundej toka?
 - Po ti çfarë bën kur tundet toka?
- Çfarë do i këshilloje fëmijëve të tjerë që kanë frikë si Toni të bënin?
 - Si u ndjeve kur ra tërmeti?
 - Po tani si ndihesh kur e kujton?

Vizatoni në një fletë frikën tuaj nga tërmeti.

Tutu dhe Elefantushi kërkojnë fëmijët

Tutu kishte kohë që nuk dëgjonte më asnjë zë fëmije. Prej marsit, asnjë prej tyre nuk vinte pranë shtëpisë së tij. Ai doli jashtë për të parë nëse fëmijët ishin duke ardhur, por sado që ecte nuk shihte këmbë njeriu. Tutu ishte mësuar të luante me fëmijët. Ata e donin shumë dhe ai i donte më shumë. Duke sjellë në mendje kujtimet e bukura, eci derisa mbërriti në qytet. Tutu vështroi rrugët dhe parqet bosh dhe u trishtua shumë. Ku ishin fëmijët? Në mes të një parku pa një hije.” Ah - mendoj me vete - i gjeta”. U hodh nga një degë në tjetrën për t’i parë nga lart fëmijët, por pikërisht kur mendoj se po zbulonte hijen misterioze, dalloj një feçkë të gjatë që doli nga pema.

- Kush je ti? - pyeti Tutu.

Feçka u mbledh pas pemës dhe hija filloi të lëvizte. Gjethet e mëdha nuk po e linin Tutunë të shikonte mirë. Hija lëvizi dhe u vendos në mes të barit. Tutu largoi gjethet dhe pa poshtë pemës një elefant.

- Unë jam Elefantushi. Po ti kush je?

- Jam Tutu - tha ai duke u ulur afër veshëve të tij të gjatë.

Elefantushi e kapi me feçkë dhe e vendosi Tutunë në bar përpara syve, që ta shikonte më mirë.

- Çfarë po bën në qytet? - e pyeti Elefantushi.

- Po kërkoj fëmijët. Ata vijnë pranë shtëpisë sime dhe luajmë bashkë - ia ktheu Tutu.



- Ata luajnë me mua – tha Elefantushi.

- Jo, nuk luajnë me ty, por me mua- kundërshtoi Tutu.

Të dy filluan të bënin garë se cilin prej tyre donin më shumë fëmijët. Zhurma sa vinte dhe po bëhej më e madhe. Fëmijët e lagjes pranë parkut dolën në dritare e ballkone për të parë se çfarë po ndodhte. Pas tyre edhe prindërit.

- Oh - thirri njëri prej tyre- shikoni paska ardhur Tutu !

Nga një ballkon u dëgjua edhe zëri i një vajze të vogël.

- Elefantush, paske ardhur? Sa më kishte marrë malli!

Elefantushi dhe Tutu e lanë grindjen sapo dëgjuan zërat e fëmijëve. Ata këputën nga një luledede dhe u nisën me vrap kush e kush të arrinte i pari te fëmijët. Një djalë hodhi nga ballkoni një banane për Tutunë ndërsa një vajzë i dha Elefantushit një degë plot me gjethe të njoma nga kopshti. Tutu dhe Elefantushi ishin të lumtur që i kishin gjetur fëmijët.

- Përse nuk keni ardhur të luani? - i pyeti Elefantushi.

Fëmijët u treguan miqve të tyre se një mikrob po sëmurte njerëzit dhe ata duhet të qëndronin në shtëpi. Nuk mund të shkonin në kopsht apo në pyll, dhe as teatër, dhe as të takoheshin me njëri tjetrin. Elefantushi dhe Tutu menduan se kjo ishte shumë e mërzitshme.

- Nuk bëjmë dot më asgjë si ditët e tjera - ia priti një djalë që kishte vendosur një maskë para gojës.

- Dua të dal, por kam frikë - u ankua një vogëlush tjetër në ballkonin e katit të tretë.

- Por duhet të rrimë larg dhe të kemi kujdes, sepse gjyshërit tanë mund të sëmuren. Ne i duam shumë gjyshërit - shpjegoi një vajzë me kaçurrela.

- Po ne nuk na doni? - u ankua Elefantushi.

- Edhe juve ju duam shumë dhe ju premtojmë që do të vijmë t'ju takojmë, por tani nuk mundemi - ua ktheu djali me maskë.

- Do të vini të luani me mua në fillim? - tha Tutu.

- Jo, do të vijmë tek unë se jam i pari. Më duan më shumë - foli me nxitim Elefantushi.

Të dy po grindeshin sërish, por e qara e një fëmije i ndërpreu. Atëherë Tutu filloi të hidhej në ajër sikur të ishte në cirk. Kur bëri një kollotumba, këmba i rrëshkiti dhe do të kishte rënë në një pegg me ujë nëse nuk do ta kishte kapur Elefantushi me feckën e tij. Djali i vogël filloi të qeshte. Tutu dhe Elefantushi vazhduan të bënin lojëra ndërsa fëmijët i duartrokisnin të lumtur. Njëri prej tyre hodhi një mollë të kuqe nga dritarja dhe Elefantushi e kapi me feçkë. Kështu po kalonin nga një shtëpi në tjetrën, nga një dritare në një ballkon duke kënaqur të gjithë fëmijët e qytetit, derisa dielli perëndoi.

Kishte ardhur koha që Elefantushi dhe Tutu të ktheheshin në shtëpi, ndërsa fëmijët të shkonin në shtrat për të fjetur. Gjatë kthimit ata kuptuan se ishin më të lumtur dhe ishin bërë miq të mirë. Fëmijët i donin shumë që të dy. Dhe ata i donin shumë fëmijët. Ndaj të nesërmen dhe ditët më pas do të shkonin përsëri pranë tyre për të luajtur dhe për t'u gëzuar së bashku derisa fëmijët të dilnin sërish e të mbushnin rrugët e qytetit dhe shtigjet e pyllit.

Për prindërit dhe edukatorët

Kjo përrallë flet për situatën e karantinës që kaluam. Për të rriturit dhe fëmijët ishte një situatë e pazakontë, por fëmijët kanë nevojë të kuptojnë çfarë është virusi, si shpërndahet ai, si mund të mbrohemi prej tij. Këto shpjegime nuk duhet të vijnë me aktivizimin e frikës që njerëzit e afërm do të sëmuren apo vdesin, sepse nuk ndihmohet fëmija. Çdo sjellje që ai ndërton mbi bazë të frikës është e përkohshme. Fëmija ka nevojë të udhëhiqet me mençuri përse duhet pasur kujdes, së pari si respekt për trupin e tij dhe mjedisin ku jeton. Pra, udhëhiqet përmes shembujve tuaj të respektojë veten dhe të tjerët. Nëse ju zbatoni higjienën e duhur, distancën e duhur, kujdesin e duhur pa aktivizuar frikërat, fëmijët do kuptojnë situatën dhe do reagojnë më shëndetshëm lidhur me të.

Fëmijët po ashtu, kanë nevojë të mësojnë se në jetë do të hasin edhe situata të papritura dhe se është e nevojshme të përshtaten me situatat e reja jetësore duke bërë ndryshimet e nevojshme në sjellje, apo aktivitete, me qëllim që të mund të ruajnë funksionimin e tyre të shëndetshëm.

Pyetje për fëmijët

- Përse u habitën Tutu dhe Elefantushi kur zbritën në qytet?
- Ku ishin fëmijët?
- Përse fëmijët nuk dilnin nga shtëpia?
- Si ia shpjeguan fëmijët Tutusë dhe Elefantushit atë që po ndodhte?
- Çfarë bënë fëmijët kur panë Elefantushin dhe Tutunë?
- Përse u mërzitën me njëri tjetrin Tutuja dhe Elefantushi?
- Përse u pajtuan ata? Çfarë kuptuan?
- Po ju çfarë bëtë gjatë karantinës?
- Cilat ishin aktivitetet që ju pëlqyen më shumë në karantinë?
- Po të ishit në qytetin ku shkuan Elefantushi dhe Tutuja çfarë do u kishit treguar atyre?
- Si u ndjeve gjatë karantinës?

Vizatoni vendin tuaj të preferuar në shtëpi.

Vizatoni me ndihmën e të rriturve qytetin në karantinë.

Dino vizaton porositë

Dino është i mërziur. Ai ka dëgjuar se mikrobet mund të sëmurin atë dhe familjen e tij. Dino ka frikë dhe pyet prindërit se si mund të ruhet që të mos sëmuret.

- Duhet të lash duart vazhdimisht. Sidomos para se të hash. Duhet të vendosësh bërrylin kur teshtin apo kollitesh. Duhet të qëndrosh të paktën një metër larg nga shokët dhe duhet të rrish më shumë në shtëpi. Nuk duhet të takosh gjyshen dhe gjyshin, sepse janë të moshuar dhe sëmuren shpejt - i thanë mami dhe babi.

- Po unë nuk i mbaj mend gjithë këto gjëra! - tha Dino - Nuk di as të shkruaj dhe as të lexoj.

Atëherë mami i dha një ide: - Bëj një vizatim për çdo rregull!

Dino i kënaqur mori letra dhe lapsat me ngjyra dhe filloi të përsëriste fjalët e prindërve: Duhet të laj duart me sapun dhe ujë vazhdimisht dhe para se të ha. Në letër ai vizatoi duart tij, një lavaman, një çezmë, sapunin dhe ujin. Sapuni ishte ngjyrë e gjelbër si bari dhe pemët, ndërsa peshqiri i bardhë si një re e bukur në qiell. Uji ishte i kaltër si deti.

Pasi lau duart ai vizatoi një banane. Ishte fruti i tij i preferuar dhe tani që ishte i pastër mund ta hante. Duke shëtitur në oborrin e shtëpisë së tij, Dino pa se lulet kishin çelur. U afrua dhe filloi të shijonte aromën e tyre, por befasi i erdhi një teshtimë. Edhe për këtë rregull, Dino kishte vizatuar një bërryl ku qëndronte goja dhe hunda e tij sa herë që duhet të kollitej dhe të teshtinte. Ashtu bëri.



Aty pranë shtëpisë së tij banonte fqinja e mirë, breshka Tafi.

- Do të bëjmë një lojë? - e pyeti ajo.

Dino kujtoi vizatimin e tij. Ai dhe Tafi nuk rrinin afër njëri - tjetrit.

- Duhet të qëndrojmë larg të paktën një metër - tha Dino.

Dhe ashtu bënë e luajtën rreth e rrotull oborrit, Tafi në një anë dhe Dino në anën tjetër.

Në mbrëmje Dinon e kishte marrë malli për gjyshen dhe gjyshin. Kishin kaluar shumë ditë pa i takuar. Babi i kujtoi vizatimin që kishte bërë. Ai kishte vizatuar veten e tij në një cep të letrës dhe gjyshërit, në anën tjetër. Mes dy cepave, Dino kishte vendosur një zemër të madhe! Ai mori në telefon gjyshen dhe gjyshin dhe u tregoi çfarë kishte bërë gjithë ditën. Në fund ai u tha se i donte shumë dhe kur mikrobet të largoheshin do të takoheshin dhe do t'u tregonte vizatimet që kishte bërë.

Për prindërit dhe edukatorët

Koronavirusi i ri është një virus që ka prekur shumë njerëz dhe gjithë botën. Ai mund të bëhet më pak i rrezikshëm nëse të gjithë respektojnë rregullat. Fëmijët kanë nevojë të ndihmohen t'i kuptojnë rregullat dhe t'i brendësojnë ato, sepse janë shumë të rëndësishme. Kjo përrallë flet pikërisht për këto rregulla. Është e rëndësishme që të rriturit vetë t'i zbatojnë ato. Fëmija mëson përmes modeleve të të rriturit dhe jo përmes fjalëve të tyre. Nëse fëmijët dhe të rriturit i zbatojnë rregullat, covid-19 do të jetë më pak i rrezikshëm për jetën.

Pyetje për fëmijët

- Përse ishte i mërziur Dino?
 - Çfarë i tha mami të bënte?
 - Çfarë vizatoi Dino për larjen e duarve?
 - Çfarë ngjyre kishte sapuni?
 - Po peshqiri? Po uji çfarë ngjyre kishte?
 - Përse duhet t'i lajme duart shpesh?
- Dino teshtiu kur po i merrte erës lules, ku e vendosi gojën kur teshtiu?
 - Sa larg njëri tjetrit qendruan Dino dhe breshka Tafi? Përse?
 - Çfarë bëri Dino kur e morri malli për gjyshërit?
 - Po ju, çfarë bëni kur ju merr malli për shokët, shoqet dhe familjarët?

Vizatoni ato që ka vizatuar dhe Dino: Si të lajmë duart; Si të teshtijmë dhe kollitemi; Si të mbajmë distancën. Praktikoni me shokët dhe familjen këto rregulla.

Biskota e fundit

- Tregim -

Fmës i pëlqejnë shumë biskotat. Aq shumë sa nuk i ndan me asnjë tjetër. Një ditë kishte mbetur vetëm një biskotë në shtëpi dhe Ema mendoi ta hante vetë. Por Andi, vëllai i saj më i vogël, e pa dhe kërkoi ta hante ai biskotën. Të dy fëmijët filluan të grindeshin, kush e kush të hante biskotën e fundit. Zhurma u bë kaq e madhe, saqë mami hyri në dhomën e fëmijëve e shqetësuar.


- Biskota ime! - thoshte Andi duke qarë.

- Jo, biskota është e imja. Unë jam më e madhe se ty! - ia kthente Ema.

Andi u mundua t'ia merrte biskotën nga dora, por Ema nuk e lëshonte.

- Çfarë po ndodh këtu? - pyeti mami.

Ema dhe Andi filluan të flisnin.



- Ai ka ngrënë më shumë biskota. Kjo është e imja. E kam ruajtur që dje, - tha Ema.

- Jo mami, unë jam më i vogël. Më takon mua, - qante Andi.

Atëherë mami vendosi që ta ndante në dy pjesë të barabarta biskotën, por kur e pa që të dy fëmijët ishin të pakënaqur, u tha:

- Kush do të më ndihmojë që të bëjmë biskota?

Fëmijët e harruan zënkën dhe u hodhën përpjetë nga gëzimi.

Të tre shkuan në kuzhinë dhe filluan përgatitjen.

- Mami, mund t'i thyej unë vezët? - pyeti Ema.

- Patjetër, të dy bashkë mund të thyeni vezët. Por, të lutem Ema, më ndihmo të hedhim pak kripë në miell, - tha mami.

- Po mami, unë kam shumë qejf kur të ndihmoj.

- Edhe unë, - tha Andi.

- Falënderit, zemrat e mamit.

- Mami, unë di ta hedh miellin vetë, - tha Ema dhe pa pritur përgjigjen, ktheu miellin menjëherë në tasin ku ishin vezët.

Një re e madhe, e bardhë u përhap në kuzhinë. Kur pluhuri u shpërnda, mami, Ema dhe Andi panë fytyrat e tyre të zbardhura nga mielli.

- Oh, më fal mami. Nuk desha ta bëja gjithë këtë rrëmujë, - tha Ema, e zënë në faj.

- Nuk prish punë, por herë tjetër mos bëj asgjë pa të thënë unë, - iu përgjigj mami duke qeshur.

Ndërsa mami dhe Ema po bisedonin, Andi ishte fshehur pas divanit dhe doli, duke folur me zë të hollë:

- Unë jam mama dhia!

Mami dhe Ema filluan të qeshnin dhe i thanë:

-Ti nuk e ke këmbën të bardhë.

Por Andi vazhdoi të luante derisa mielli u shkund nga fytyrat e të treve. E ndërsa ata luanin, në tasin e kuzhinës, tashmë ishte formuar një brumë i butë. Mami e hapi mbi tryezë për ta ndarë në disa pjesë.



Emë dhe Andi morën format e biskotave dhe filluan të bënin lule, yje, gërma e plot figura të tjera. Mami i vendosi biskotat në tepsi, ndezi furrën dhe i vuri për t'i pjekur.

Pas disa minutash, një aromë e mrekullueshme biskotash të pjekura u përhap në gjithë kuzhinën. Emë dhe Andi atë ditë hëngrën biskotat më të mira në botë. Doni të dini kush e hëngri biskotën e fundit? Pyetni Emën!

Për prindërit dhe edukatorët

Ky tregim mund të ndihmojë fëmijët të kuptojnë sesi mund të përballojnë ndjenja të vështira, si zemërimi. Fëmijët e kanë të vështirë të mbajnë brenda emocionet e forta. Kur fëmijët ndihen të tejlovdhur, të mërztur, të zhgënjyer, të zemëruar, ato i shprehin këto ndjenja duke qarë, bërtitur ose përplasur lodrat, sendet e tyre, lart e poshtë. Krizat dhe shpërthimet e zemërimit janë pjesë normale e zhvillimit të fëmijës, gjatë kohës që ai mëson vetëkontrollin. Me rritjen e fëmijës, shpërthimet e zemërimit fillojnë të stabilizohen.

Zemërimi është një emocion normal, gjithsesi kjo është një përvojë frikësuese si për personin që është i zemëruar, ashtu edhe për ata që janë dëshmitarë të zemërimit. Frika dhe zemërimi i të rriturve nuk i ndihmon fëmijët të kontrollojnë zemërimin e tyre, përkundrazi e përforcon atë. Të rriturit kanë detyrë t'u shpjegojnë fëmijëve që e kuptojnë zemërimin e tyre, por nevojitet të mësojnë mënyra të tjera për ta shprehur atë.

Pyetje për fëmijët

- Si mendon ti, pse u zemërua Emë? Po Andi?
 - Çfarë bëri mami për t'i qetësuar fëmijët?
 - Si mund ta zgjidhnin zënkën fëmijët, nëse nuk do të ndërhynte mami?
 - A duhet të zemërohen fëmijët me njëri-tjetrin?
- Çfarë bën ti kur shokulshoqja jote zemërohet me ty?
 - Si mendon, pse fëmijët zemërohen me njëri-tjetrin?
 - Çfarë bën ti ku je i zemëruar?

Kukulla me makinë të kuqe

- Tregim -

Kristina është një nga vajzat e pallatit tim, që dalin çdo ditë për të luajtur. Ajo është vajzë e vetme por ka shumë dëshirë që mami t'i bëjë edhe një motër.

- Kur do të kem një motër, mami? - pyeste ajo mamin me padurim.

- Po të jetë vëlla? - e pyeste mami.

- Jo nuk dua vëlla, dua vetëm motër!

- Po përse? Vëllai është shumë i mirë.

- Vëllai është çun. Çunat janë shkatarraqë, të prishin lodrat, dinë të luajnë vetëm me makina.- përgjigjet Kristina duke qarë.

- Po kush të ka thënë se çunat janë kështu?

- E ke parë Besin që nuk di të luajë fare me mua? E ke parë, o mami si bën ai? Vetëm të bërtasë dhe të luajë me makina di. Unë dua një motër që ta kem shoqe edhe në shtëpi.

Kaq thoshte Kristina dhe shkante të luante me kukullat e saj.

Besi është kushëriri i Kristinës. Sa herë që ai vjen në shtëpinë e saj, merr me vete edhe disa makina, të mëdha, që asaj nuk i pëlqejnë fare. Ndonjëherë ata grinden dhe prindërit e tyre lodhen shumë për t'i pajtuar.

Ditët kaluan dhe erdhi koha që Kristina të shkante për herë të parë në kopsht. Ajo ishte shumë e kënaqur që do të takonte fëmijë të tjerë.

- Sa mirë mami, do të njoh shumë shoqe, - tha ajo e gëzuar.

- Edhe shokë do të njohësh, - u përgjigj mami.

Kristina rrudhi buzët. Nuk donte të luante me asnjë djalë të kopshtit. E dinte se do të fillonin të ziheshin, të bërtisnin, të shtynin e të luanin prapë me makina. Duke menduar këto gjëra, ajo pa se kishin mbërritur në derën e kopshtit. E përqafoi mamin dhe i dha dorën edukatores. Klasa e saj ishte shumë e bukur. Në mure ishin vizatuar shumë personazhe përrallash, një lëndinë me lule dhe me zogj. Në murin përballë ajo pa të vizatuar edhe një makinë të kuqe. Edhe pse makina i kujtoi Besin, i pëlqeu shumë, madje iu duk akoma më e bukur kur pa një vajzë të ulur në timonin e makinës.

Orën e parë të mësimit fëmijët u njohën me njëri-tjetrin. Ata thanë emrat e tyre dhe sa vjeç ishin. Në mes të të gjithëve Kristina vuri re një vajzë që nuk rrinte asnjë çast në vend. Ajo fliste vazhdimisht dhe bënte zhurmë.

Pas bisedës, edukatorja hapi lodrat dhe i ftoi të gjithë fëmijët që të merrnin nga një lodër e të luanin bashkë.

Kristinës i pëlqeu shumë një kukull me flokë të verdhë dhe e mori menjëherë. Një dorë tjetër e shtyu dhe po të mos ishte mbajtur tek një djalë që e kishte emrin Drini, do të ishte rrëzuar.

- Unë jam Teuta, kapitene e anijes dhe ju urdhëroj që të më bindeni. Që sot të gjithë bashkë do të luftojmë kundër piratëve.

Si tha këto fjalë, vajza me emrin Teuta rrëmbeu një anije me vela dhe filloi të thërriste në të gjithë klasën.

- Lëvizni ushtarë, bindjuni kapitenes suaj! Piratët po vijnë!

Disa vajza dhe djem me sa duket e pëlqyen këtë lojë dhe u përgjigjën:

- Jemi gati. Ku janë?

Kaq u desh dhe loja filloi. Të gjithë kërkonin të gjenin piratët dhe t'i mundnin ata.

Kristina rrudhi buzët dhe kërkoi një cep të qetë ku të luante me kukullën e saj.



Teksa po i krihte flokët dëgjoji një djalë që i tha:

- Unë jam Drini. A luajmë bashkë?
- Po ti je çun dhe luan me makina, - u përgjigj Kristina.
- Pse kukulla jote nuk i jep makinës? - ia ktheu përgjigjen menjëherë Drini.

Kristina mendoi se Drini kishte të drejtë. Ata filluan të luanin të dy. Njëherë i jepte makinës ai, njëherë ajo. Kukulla e bukur qëndronte gjatë gjithë kohës e ulur në makinë, ndërsa ata të dy i bënë shëtitje. Makina kishte një bori, muzikë, ndërsa dritat e saj ndizeshin dhe shuheshin, sa herë që ndalonte.

Papritur u dëgjua sërish zëri i Teutës:

- Një anije piratësh! - bërtiti ajo me sa fuqi që kishte dhe drejtoi gishtin nga makina e kuqe me kukullën e ulur. - Ta shkatërrojmë!

Si tha këto fjalë, u afrua te makina dhe e goditi me një kub lodër. Fëmijët që po luanin me të, filluan të gjuanin gjithashtu. Drini dhe Kristina përpiqeshin më kot t'i ndalonin. Brenda pak minutash, makina dhe kukulla ishin bërë copa - copa.

Kjo nuk ishte një ditë e bukur për Kristinën.

Kur u kthye në shtëpi i tha prindërve se do të ishte e lumtur nëse do të kishte një vëlla.

- Përse?! - pyeti mami, e çuditur që vajza e saj kishte ndërruar mendim.

Kristina i tregoi gjithçka që kishte ndodhur; sesi ajo kishte parë një makinë të bukur me një kukull në mur, sesi kishte gjetur kukullën mes lodrave, sesi kishte filluar të luante me një shok që quhej Drini, që ishte sjellë shumë mirë me të. Ndërsa Teuta, ajo vajza që e quante veten kapitene, kishte prishur lojën e tyre. Në fillim ajo ishte

çuditur kur e kishte parë që bërtiste, sikur të ishte një djalë.

- Çdo fëmijë mund të bërtasë, ose të mos sillet mirë, qoftë vajzë apo djalë. Teutës i pëlqen ajo lojë, por kjo nuk do të thotë që ajo është si një djalë dhe as që është një vajzë e keqe, - tha babi.

- Ndoshta mund të ishte sjellë pak më mirë dhe të mos e prishte lojën tuaj, - shtoi mami.

Kristina mendoi se prindërit e saj kishin të drejtë. Të nesërmen ajo shkoi sërish në kopsht. Luajti përsëri me Drinin, ndërsa Teuta e cila e kishte kuptuar gabimin u kërkoi të falur. Jo vetëm kaq. Ajo kishte sjellë një makinë të re me një kukull si ato që kishte prishur. Të tre luajtën bashkë dhe u bënë shokë. A vazhdonte të luante më Teuta me piratë? Po, ajo ishte loja e saj e preferuar, por tani ajo nuk bërtiste, ndërsa mes ushtarëve të saj ishin shtuar edhe Kristina me Drinin.

Për prindërit dhe edukatorët

Ky tregim ndihmon fëmijët të kuptojnë marrëdhëniet gjinore dhe të shmangin krijimin e stereotipeve gjinore¹. Stereotipet gjinore i bëjnë djemtë dhe vajzat ta shohin dhe trajtojnë veten e tyre në mënyrë të ngushtë dhe kufizuese. Duke u rritur fëmijët mësojnë ta privojnë vetë veten dhe të tjerët nga të drejtat dhe liritë e tyre.

Në moshën parashkollore fëmija mëson se cilës gjini i përket. Por, lojërat, sportet, profesionet, mundësitë, nuk janë të ndara veçmas për vajzat dhe veçmas për djemtë. Të gjitha mundësitë për zhvillim, edukim, shkollim, të

1. Mënyra të ngurta dhe të paracaktuara sesi shihen vajzat dhe djemtë në shoqëri e familje. Sipas stereotipeve gjinore, djemtë dhe vajzat duhet të sillen në mënyra të ndryshme, kanë të drejta dhe liri të ndryshme dhe detyrime e përgjegjësi të ndryshme.

drejtat, liritë dhe detyrimet duhet të jenë njësoj për të dyja gjinitë.

Kur fëmijët mësojnë se të jesh djalë apo vajzë, nuk të bën as më të mirë, as më të keq, ata mësojnë të jenë më bashkëpunues, më të dashur me njëri-tjetrin dhe më pranues ndaj vetes. Këta fëmijë mësojnë të jetojnë më të lumtur me veten dhe të tjerët.

Pyetje për fëmijët

- Çfarë të pëlqen më shumë te ky tregim?
- Me çfarë të pëlqen të luash më shumë?
- Në kopshtin tënd ti luan më shumë me vajzat, apo me djemtë?
- Nëse je djalë: çfarë lojërash luan me vajzat e kopshtit tënd?
- Nëse je vajzë: çfarë lojërash luan me djemtë e kopshtit tënd?
- Nëse je djalë: çfarë të pëlqen më shumë kur luan me vajzat e kopshtit tënd?
- Nëse je vajzë: çfarë të pëlqen më shumë kur luan me djemtë e kopshtit tënd?

Biçikleta

- Tregim -

Një biçikletë e re po priste në dyqan, gati për t'u bërë dhuratë e bukur për një djalë me emrin Olsi. Prindërit e Olsit e kishin parë dhe kishin vendosur t'i plotësonin atij dëshirën, pikërisht me rastin e ditëlindjes. Ata e blenë biçikletën dhe kur Olsi u zgjua nga gjumi i thanë:

- Shko të shikosh se dikush po të pret në korridor!

Olsi i çuditur vrapoi dhe kur u gjend në korridor, filloi të thërriste i gëzuar:

- Biçikletë, një biçikletë e bukur për muaaaa!

- Gëzuar ditëlindjen dhe u bëfsh 100 vjeç, Olsi! - e uruan prindërit.

- Faleminderit mami, faleminderit babi. Kjo është dhurata më e bukur që më keni bërë ndonjëherë. Dua të bëj një xhiro tani! - tha Olsi i paduruar.

- Prit Olsi, ti nuk ke ngrënë akoma mëngjesin! - tha mami dhe të tre u ulën në tavolinë.

Buka me gjalpë dhe gota e qumështit mbaruan më shpejt se çdo ditë tjetër, sepse Olsi mezi priste që të bënte një xhiro me biçikletë.

Ai lau duart dhe buzët, veshi pantallonat e bukura dhe një këmishë të bardhë dhe u kthye në dhomë duke thënë:

- Mami, babi do të dalim, se unë dua të mësoj të ngas biçikletën!

Prindërit e Olsit buzëqeshën. Olsi u çudit.

- Olsi, a nuk mendon se veshja jote nuk shkon fare me këtë biçikletë?



Olsi nuk po kuptonte gjë. Atëherë mami filloi të shpjegonte.

- Kur bëhet xhiro me biçikletë, vishen tuta dhe një bluzë e lirshme që mos të pengojnë, sepse trupi duhet të jetë i lirë. Këmbët do të lëvizin dhe duart duhet t'i mbash fort tek timoni.

Ndërsa babi u ngrit dhe nxori nga kutia disa gjëra të çuditshme, të cilat Olsi i kishte parë vetëm në garat e çiklistëve.

- Përveç rrobave, duhet patjetër të vësh këtë kokore që të ruash kokën, dhe këto gjunjëza që të ruajnë gjunjët dhe bërrylat, - i tha babi Olsit.

Por djalit nuk i pëlqyen aspak fjalët e babit.

- Po unë kështu do të ngjaj i shëmtuar, o babi!

- E rëndësishme është që të jesh i siguruar, - shtoi mami.

Por, Olsi vazhdoi të këmbëngulte se nuk i pëlqente aspak të vinte kokore dhe as gjunjëza. Ai mori biçikletën, ndërsa prindërit e ndoqën pas, deri në oborrin e shtëpisë.

Babi filloi t'i mësonte biçikletën. Dy xhirot e para ai e mbante Olsin, derisa sa ai u ndie mirë dhe i tha babit:

- Më lësho babi se tani e mësova! Më lësho, më lësho!

Babi e lëshoi dhe Olsi eci përpara me biçikletë. Pikërisht kur filloi të lëvizte më shpejt këmbët, një gur i vogël i doli para dhe biçikleta u pengua. Olsi u rrëzua.

Prindërit vrapuan drejt Olsit që tani po qante dhe panë se nga gjuri po i rridhte gjak, ndërsa në kokë po i dilte një xhungë e madhe dhe e kuqe.

Ata i mjekuan këmbën dhe ballin Olsit, i cili tani ndihej i mërziur që nuk kishte dëgjuar mamin dhe babin. Ditët kaluan dhe plagët u shëruan. Olsi mësoi t'i jepte biçikletës dhe asnjëherë nuk harroi të vinte kokoren dhe gjunjëzat.

Për prindërit dhe edukatorët

Ky tregim, ndihmon fëmijët të kuptojnë se është e rëndësishme të kujdesen për sigurinë e tyre, por pa penguar dëshirën dhe nevojën e tyre për të mësuar. Siguria e fëmijëve është një nga çështjet më jetësore për çdo familje. Fëmijët kanë nevojë për mjedise ku të vrapojnë, të hidhen, të ngjiten dhe pëlqejnë mjediset e lojës ku mund të zhvillojnë aftësitë e tyre fizike. Mos ua ndaloni ato për të qenë të sigurt, por, ndihmojini fëmijët të rrisin vetëbesimin e tyre dhe të mësojnë se çfarë duhet të bëjnë, që të jenë më të sigurt në vetvete. Kjo vlen edhe për brenda shtëpisë, kur ju nuk ndodheni aty.

Përcaktojini qartë rregullat, si dhe i lavdëroni fëmijët në rastet kur ata i realizojnë këto këshilla. Kjo është një mënyrë efektive për të ndihmuar fëmijën të mësojë shprehitë e sigurisë në situata të rrezikshme. Ndonjëherë fëmijët mund të kenë nevojë t'ua përsërisni disa herë, duke ua shpjeguar hollësisht, derisa ata të kuptojnë nese një sjellje është e sigurt ose jo. Është shumë e rëndësishme që mësimi i këtyre elementeve të sigurisë të mos bëhet duke i frikësuar fëmijët.

Pyetje për fëmijët

- Çfarë mendon për këtë tregim?
 - A të pëlqen Olsi?
 - Mund të më tregosh nga se ke frikë ti? Si ia bën për t'u ndier i/e sigurt?
- A mund të kujtojmë bashkë situata ku duhet të sigurohemi? (Kujtoni kalimin e rrugës, semaforin, karrigen e sigurisë për fëmijët në makinë, krahëzat apo kamerdaret e notit etj.).

Zogu i vogël Xhexhe

- Përrallë -

Xhexhe është një trumcak i bukur që jeton në pyll bashkë me familjen e tij. Ata e kanë follenë në degët e një peme të madhe. Xhexhe ishte më i vogli nga të gjithë vëllezërit e motrat, ndaj prindërit i japin më shumë këshilla. “Mos u largo nga shtëpia vetëm!”, “Mos u fol të panjohurve!”, “Mos i afro dhelprës!”-i kujtonin shpesh zogut të vogël më të rriturit. Xhexhe tundte kokën në shenjë pohimi dhe përpigëj t’i mbante mend të gjitha porositë.

Atë ditë dielli ishte shumë i bukur dhe Xhexhe sapo ishte zgjuar. Kishte ngrënë mëngjesin që i kishte bërë mamaja dhe po shikonte i gëzuar gjelbërimin e gjetheve. Pastaj ai pa disa re të vogla që iknin me vrap nëpër qiell dhe së fundi sytë i rrotulloi poshtë, në tokë. Mes fijeve të barit ai dalloj një lule të kuqe që nuk e kishte parë ndonjëherë aty pranë. Fluturoi nga foleja dhe u soll rreth e rrotull saj:

“Sa lule e bukur! Nuk e kam parë ndonjëherë këtej pranë. Me siguri e ka sjellë era”, mendoi me vete Xhexhe. Hodhi vështrimin rreth vetes dhe pa plot lule të tjera si ajo. Atëherë filloi të fluturonte tek të gjitha. E ndërsa zogu i vogël po kënaqej duke parë lulet, një dhelprë e uritur erdhi aty pranë. Kur pa Xhexhenë, lëpiu buzët dhe mendoi: “Oh, po ky është një mëngjes i mrekullueshëm për mua!”

Dhe si dhelprë që ishte mendoi një plan. Lu afrua një luleje dhe tha: “Oh sa e bukur je! Nuk të kisha parë nga kjo anë e pyllit. Po ti zog i bukur, si e ke emrin?”

Xhexhe e vështroi me kujdes. Kafsha po i dukej e njohur. Ai nuk kishte parë kurrë dhelbër me sy, por mami dhe babi i kishin treguar një fotografi që ta njihnte. Megjithatë, kjo kafshë nuk i po dukej aspak e keqe. Ajo kishte një lëkurë me ngjyrë të bukur dhe sytë e saj dukeshin kaq të ëmbël kur i flisnin. Bëri të hapte gojën, por menjëherë iu



kujtua këshilla e mamit: “Mos i fol të panjohurve!”

Dhelpra e kuptoi dhe vazhdoi të fliste: “Oh sa keq, zog i gjorë, ti nuk mund të flasësh? Je kaq i bukur dhe nuk ke zë? Kushedi sa po vuan. Vetëm zëri të mungon për të qenë zogu më i bukur i këtij pylli.”

Atëherë Xhexhe mendoi se nuk do të ishte problem, nëse do t’i thoshte të paktën emrin. Edhe po t’i fliste ajo, nuk do ta hante dot, se ai do të fluturonte shumë shpejt.

- Xhexhe më quajnë, - tha ai.

- Oh gëzohem! Ti paske edhe zë, edhe emër shumë të bukur, - ia ktheu dhelpra shumë e lumtur dhe pas pak foli sërish. - Luajmë bashkë roza - rozina?

Xhexhe nuk e kishte bërë ndonjëherë këtë lojë, por dhelpra i shpjegoi se duhet të kapeshin përdore dhe të rrotulloheshin duke kënduar. Në fund të këngës do të uleshin të dy bashkë në bar.

Xhexhes i pëlqeu shumë kjo lojë dhe ishte gati të pranonte, por një çast mendoi: “Po sikur të jetë një dhelprë ndryshe nga të tjerat? Duket kaq e dashur me mua! Nuk besoj se do të më hajë”. Por prapë kishte frikë, ndaj tha:

- Ti je një dhelprë. Mami dhe babi më kanë thënë që nuk ka dhelprë të mirë. Të gjitha ato duan t’i hanë zogjtë.

- Është e vërtetë, por unë jam një dhelprë ndryshe nga të tjerat. Unë nuk ha zogj, Prandaj nuk më duan më dhelprat e tjera, - tha dhelpra dhe filloi të qante.

Xhexhesë i erdhi keq, por teksa e shikonte dhelprën, iu kujtuan shumë përralla që mami i kishte treguar përpara se të flinte. Në të gjitha përrallat dhelpra hiqej sikur ishte e mirë dhe pastaj i hante zogjtë. Atëherë Xhexhe mendoi se nuk duhet

të luante me dhelpren dhe i tha:

- Jo unë nuk luaj me ty, sepse ti je e rrezikshme!

Dhelpra filloi të qante akoma edhe më shumë, por zogu i vogël u ngjit lart në fole dhe nuk zbriti më. Një iriq që kishte dëgjuar bisedën mes dhelpres dhe Xhexhesë, u mblodh i tëri dhe u rrokullis drejt dhelpres duke ia ngulur gjembat e tij në trup.

Dhelpra bërtiti fort nga dhimbja dhe u largua menjëherë nga pylli.

Kur prindërit u kthyen në fole, Xhexhe u tregoi të gjithë atë që kishte ndodhur. Ata u gëzuan shumë që djali i tyre i kishte thënë “jo” dhelpres dinake dhe kishte shpëtuar jetën e tij.

Për prindërit dhe edukatorët

Kjo përrallë mund të ndihmojë fëmijët të kuptojnë se është e rëndësishme që në situata të caktuara të refuzojnë, si dhe të mësojnë mënyrat si mund të realizohet kjo. Refuzimi është pjesë normale e rritjes dhe e jetës së fëmijës. Të kesh një opinion ndryshe, qoftë edhe nga prindërit apo edukatorët, është një dukuri shumë normale.

Të rriturit nuk duhet të frenojnë aftësinë e fëmijëve për të refuzuar ato çka u duken të papërshtatshme si dhe argumentet që zgjedhin në mbrojtje të tyre. Ndodh që në familje, “jo”-ja apo refuzimi shkaktojnë tone të ngritura dhe zemërim, ndonjëherë në mënyra problematike. Për rrjedhojë fëmija mund të mësojë që refuzimi, kundërshtimit apo mosdakordësia është diçka e frikshme dhe e gabuar. Për rrjedhojë, ata mësojnë të përjetojnë ankth kur kundërshtojnë. Të mësosh fëmijën të refuzojë, e ndihmon atë të mbrohet në situata dhe nga persona jo të përshtatshëm, si dhe të zhvillojë integritet personal.

Pyetje për fëmijët

- Të pëlqen zogu Xhexhe?
 - Çfarë mendon për sjelljen e zogut Xhexhe ndaj dhelpres?
 - Çfarë do të bëje ti në vend të Zogut Xhexhe?
 - Po ti si sillesh kur takon njerëz të panjohur dhe je vetëm në park, kopsht ose diku tjetër?
- A mund të flasim për ndonjë situatë ku ti duhet të sillesh si zogu Xhexhe? (Lëreni fëmijën ta mendojë. Më pas jepni ju shembuj situatash ku fëmija nuk duhet të flasë me të panjohurit, apo situata të tjera ku refuzimi do të ishte i përshtatshëm).
 - Po kur diçka nuk të pëlqen, si kundërshton ti?

Një ditë në kopshtin zoologjik

- Tregim -

Mëngjeset janë shumë të bukura në kopshtin e lagjes sime. Çdo ditë prindërit sjellin fëmijët, të cilët pasi ndahen prej tyre, futen në kopsht plot gëzim, sepse për ata ai është kopshti më i bukur në botë. Por, ky mëngjes që sapo kishte ardhur, do të sillte një gëzim më shumë për fëmijët. Edukatorja hyri në mes të fëmijëve dhe u tha:

- Të dashur fëmijë, sot do të bëjmë një lojë shumë të bukur!

Si tha këto fjalë, ajo vuri mbi tryezë një kuti të madhe kartoni.

- Çfarë shikoni këtu? - pyeti edukatorja, duke treguar me gisht figurën e madhe në njërën anë të kutisë.

Fëmijët ngritën duart e vogla dhe edukatorja i dha leje Altinit që të fliste i pari.

- Unë shikoj tre tigra, edukatore, - tha ai i gëzuar.

- Unë shikoj një police, - u hodh e tha Mira.

E kështu me radhë, fëmijët treguan të gjitha ato që ishin në figurë; një elefant i madh dhe një elefant i vogël, dy foka, një gjirafë, katër zogj me pendët ngjyra-ngjyra, pesë mjellma të bardha si bora, një ujk, dy dhelpra, katër arinj, disa majmunë e shumë kafshë të tjera, emrat e të cilëve ua tregoi edukatorja. Gjithashtu ata panë edhe dy roje, një dyqan akulloresh e karamesh, një vend ku priteshin biletat dhe më në fund kuptuan se bëhej fjalë për një kopsht zoologjik.

- Pikërisht, - tha edukatorja, kur dëgjoi fëmijët që e gjetën se çfarë kishte brenda

në kuti - do të ndërtojmë së bashku një kopsht zoologjik. Pastaj, disa prej jush do të punojnë në këtë kopsht, ndërsa disa të tjerë do të jenë vizitorët.

Fëmijët u hodhën përpjetë nga gëzimi. Ata ishin shumë të lumtur me lojën e re dhe filluan të ndanin punët.



- Unë dua të jem police! - tha Mira që e kishte pëlqyer aq shumë atë kukullën e vogël me uniformë blu. I kishte flokët e verdha dhe plot kaçurrela, njësoj si ajo.

- Unë do të jem zbutësi i tigrave, edukatore, - nxitoi të zinte punën e tij të parapëlqyer Altini.

Eva shprehu dëshirën që të bëhej shitësja e akulloreve dhe karameleve.

- Unë dhe babi bëjmë akullore shumë të mira në shtëpi, - tha ajo, duke tundur bishtalecat.

Edukatorja buzëqeshi dhe u tha fëmijëve që të vazhdonin kështu, për të ndarë se cilët do të punonin në kopshtin zoologjik dhe cilët do të bënë shëtitje atje. Ajo u tërhoq në një cep të dhomës dhe filloi të vinte pikturat e fundit të fëmijëve në mur.

Fëmijët ishin shumë të zënë me ndarjen e detyrave. Ata caktuan rojën, pastruesin, shitësin e biletave, shoqëruesin e vizitorëve, i cili do t'u tregonte atyre historinë e çdo kafshe dhe në fund mbeti për t'u gjetur se kush do të luante doktorin e kafshëve apo siç e quanin të rriturit, veterinerin.

- Unë jam doktori, - tha Lorenci, duke rrëmbyer nga kutia doktorin prej kukulle.

- E përse ti?- e kundërshtoi Martina. - Unë dua të bëhem veterinerja.

- Jo, unë!- tha Lorenci dhe shtrëngoi fort dorën ku kishte kukullën me përparëse të bardhë dhe me kuti ilaçesh. - Babi im është veteriner, kështu që unë do bëhem si ai.

Kur e pa Martina që Lorenci e fshehu pas vetes doktorin, u mërzi shumë. Lorenci shtrëngoi edhe më shumë lodrën dhe u largua në cep të dhomës, gati për qarë.

Edukatorja dëgjoi fëmijët dhe u afrua duke u thënë:

- Me sa po shikoj, këtu kemi dy veterinerë, por në kopshtin zoologjik ka vetëm një.

Si mendoni ta zgjidhim?

Anisa mendoi se doktori ka shumë kafshë për të vizituar, ndaj kur të çlodhej Lorenci, vendin e tij mund ta zinte Martina. Por Lorenci nuk dëgjonte ta ndante me askënd punën e tij. Kur pa që shokut të saj i pëlqente aq shumë ajo punë, Martina pranoi të mos bëhej veterinerja. Ajo u fut në grupin e vizitorëve të kopshtit zoologjik, pa bërë asnjë fjalë.

Lorenci, i gëzuar, u kthye në lojë dhe pasi ishin vendosur të gjitha kafshët në kafazet e tyre, filloi t'i vizitonte një nga një. Kur u lodh, ndaloi tek dyqani i akullores dhe kërkoi një akullore të madhe me çokollatë. Teksa hante akulloren e ëmbël, të përgatitur nga duart e vogla të shitëses Eva, ai pa fytyrën e mërzitur të Martinës. Iu kujtua që një ditë ajo i kishte dhënë qenushin me kurdisje që i kishin sjellë për ditëlindje. Lorenci kishte luajtur gjithë ditën e ishte kënaqur shumë. Që nga ajo ditë ata gjithmonë luanin bashkë. Lorenci i hodhi sytë kukullës me bluzë të bardhë që kishte ndaluar tek kafazi i arinjve. E mori në dorë dhe shkoi drejt Martinës:

- Merre, - i tha. - Tani je ti doktoresha e kafshëve.

- Me të vërtetë e ke? – pyeti Martina.

- Po. Ti je shoqja ime më e mirë, dhe unë nuk dua që të mërzitesh. Ty të pëlqen të bëhesh veteriner, por edhe unë dua të bëhem një herë vizitor i kopshtit zoologjik.

Martina u kënaq shumë që do të bëhej veteriner dhe të dy shokët u përqaftuan. Kur panë Lorencin dhe Martinën, që u pajtuan, edhe fëmijët e tjerë filluan të ndërronin rolet me shokët e tyre. Kështu që të gjithë së bashku, kaluan një ditë të mrekullueshme në kopshtin zoologjik.

Për prindërit dhe edukatorët

Ky tregim mund të ndihmojë fëmijët të mësojnë si të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin. Kurdo që fëmijët luajnë së bashku, mund të ndodhë që të lindë një konflikt, një zënkë. Tu thuash dy fëmijëve të shkojnë mirë me njëri tjetrin, nuk funksionon, jo sepse fëmijët duan të grinden, por sepse ata nuk i kanë aftësitë e mjaftueshme dhe të nevojshme për të bashkëpunuar, apo për kompromis.

Zënkat janë normale dhe të shëndetshme për fëmijët, sidomos për vëllezërit/motrat. Kështu ata mësojnë të bashkëpunojnë, të ndihmojnë njëri-tjetrin, të zgjidhin konfliktet apo të bëhen të pavarur. Një nga parimet më të rëndësishme për të nxitur bashkëpunimin dhe ndihmën është ndërvarësia pozitive. Kjo do të thotë që fëmijët të pranojnë që kanë nevojë të punojnë bashkë, secili me rolin dhe detyrën e vet, në mënyrë që të plotësojnë detyrën që iu është dhënë.

Pyetje për fëmijët

- Çfarë loje kishte menduar të zhvillonte me fëmijët edukatorja?
 - Cilat ishin disa nga rolet që morën fëmijët në kopshtin zoologjik?
 - Po ty, çfarë do të pëlqente të bëje në kopshtin zoologjik?
- Çfarë mendon se duhet të bënte Lorenci dhe Martina?
 - Çfarë kupton me fjalën bashkëpunim?
 - Si e ndihmon mamin dhe babin në shtëpi? Po edukatoren në kopsht?

Shoqja e Silvanës

- Tregim -

Kur vjen vera, të gjithë shkojnë me pushime. Edhe Silvana bashkë me familjen e saj udhëtojnë drejt plazhit, për të kaluar pushimet e tyre mes valëve të kaltra të detit, rërës së nxehtë dhe diellit që shkëlqen gjithë ditën. Ka edhe një arsye përse Silvanës i pëlqen shumë deti. Në mëngjes herët ajo del me babin dhe bashkë mbledhin guackat që kanë dalë në breg.

Kur kthehen sërish në rërë, Silvana merr me vete lodrat dhe ulet pranë çadrës për të luajtur. Por dita e parë e plazhit për Silvanën nuk është shumë e bukur. Ajo nuk njeh asnjë fëmijë në plazh dhe mërzitet duke luajtur vetëm.

Edhe atë mëngjes të parë në plazh Silvana ishte vetëm. Ajo filloi të gërmonte në rërë me lopatën e kuqe dhe pastaj mbushi kovën. E ngjeshi fort dhe e ktheu përmbys. Nga kova doli një kështjellë e bukur rëre. Kur po bëhej gati të mbushte kovën përsëri, dëgjoji zërat e dy fëmijëve. Në çadrën aty pranë kishin mbërritur një djalë dhe një vajzë, të cilët nxorën menjëherë lodrat dhe filluan të luanin. Silvana i pa lodrat e tyre që ishin njësoj me lodrat e saj. "Sikur të luaj edhe unë me ata, do të jetë më bukur," - mendoi me vete vajza e vogël. Ajo u ngrit dhe u afrua ngadalë në çadrën ku ishin duke luajtur fëmijët.

- Mirëdita! - përshëndeti ajo. - Mua më quajnë Silvana. A mund të luaj edhe unë me ju?

Djali u ngrit dhe e përshëndeti.

- Unë quhem Arbër. Kjo është motra ime Ina.

Silvana donte t'i fliste Inës, por vajza iu përgjigj menjëherë:

- Ne luajmë vetë. Kemi lodrat tona!

Silvana u mërzit dhe u largua nga çadra. Ajo donte kaq shumë të kishte shokë



e shoqe në plazh, por ajo vajza me emrin Ina nuk e donte aspak për shoqe. U ul në çadrën e saj dhe filloi të luante vetëm. Mami e pa që Silvana po rrinte e mërziur dhe e pyeti. Atëherë Silvana i tregoi për fëmijët që ishin në çadrën pranë.

- Ajo vajza nuk të njeh dhe nuk e di që ti je një shoqe shumë e mirë, - i tha mami Silvanës. - Provoje pak më vonë. Jam e bindur që do të pranojë të luajë me ty.

Silvana vazhdoi të luante me lodrat e saj. Pa u menduar shumë, kishte filluar të ngrinte një kështjellë shumë të bukur, me ura, kafshë e parqe lojërash. Kur ishte duke përfunduar lojën e saj, dëgjoi zërin e Inës.

- Përse kështjella ime rrëzohet menjëherë? - ankohej Ina. Babi i saj mendohej që ta ndihmonte, por përsëri kështjella e Inës prishej e tëra. Edhe kur qëndronte, nuk i ngjante fare një kështjelle.

Silvana mori zemër dhe shkoi drejt Inës, bashkë me formën e saj të kështjellës.

- Ina, do ta provosh me formën time? - i tha Silvana.

- Jo, - ia ktheu Ina dhe e pa me inat. - Do ta bëj vetë kështjellën time. Nuk e dua ndihmën tënde.

Silvana u largua përsëri drejt çadrës së saj. Donte të luante, por sapo bëhej gati për të mbushur formën, i kujtoheshin fjalët e Inës dhe sytë i mbusheshin me lot.

- Mos u mërzi! Motra ime nganjëherë nuk sillet mirë me ata që nuk i njeh, - tha Arbri, që ishte afruar tek çadra e Silvanës. - Kur të bëheni shoqe, do ta shikosh se ajo është shumë e mirë.

Arbri mori topin dhe të dy me Silvanën filluan të luanin.

Në çadër, Ina vazhdonte të provonte që të bënte kështjellën. Por forma përsëri

prishej. E lodhur, ajo ngriti kokën dhe pa vëllain e saj që po luante me Silvanën. I pëlqente shumë loja me top, por i vinte turp që të shkonte për të luajtur.

- Mami, - tha Ina, - dua të luaj me top, vetëm me vëllain.

- Mendoj se vëllai yt po kënaqet shumë duke luajtur me atë shoqen. Përse nuk provon edhe ti të luash me ta? Nëse nuk të pëlqen, mund ta lësh lojën dhe nuk ka asgjë të keqe - e këshilloi mami vajzën.

Ina vendosi të dëgjonte mamin dhe shkoi drejt fëmijëve.



- A mund të luaj edhe unë me ju? - tha me zë të ulët Ina.

Silvana e ndaloi lojën. Ajo u mendua, por pastaj buzëqeshi dhe tha:

- Patjetër. Luajmë të tre.

Fëmijët filluan të luanin bashkë deri sa u lodhën. Pastaj prindërit u blenë nga një akulllore dhe nën hijen e çadrës të tre shokët filluan të bisedonin.

- Silvana, do të më ndihmosh për të bërë kështjellën? Nuk e di pse më prishet, - tha Ina.

Silvana u gëzua shumë, vrapoi tek çadra e saj, mori formën dhe u kthye me një frymë.

Të tre e mbushën formën dhe e kthyen mbi rërë. Kështjella doli shumë e bukur dhe nuk u rrëzua fare. Fëmijët brohoritën të gëzuar dhe u përqaftuan fort me njëri-tjetrin.

- Kjo është kështjella më e bukur që kam parë, - tha Ina. – Faleminderit, Silvana.

- Jemi shoqe? - pyeti Silvana.

Ina pohoi me kokë dhe të tre u përqaftuan sërish. Një miqësi e re sapo kishte filluar. Ditët e tjera ishin të mbushura plot me lojëra dhe biseda interesante për fëmijët. Ata tregonin për kopshtin, shokët, shoqet, qytetin ku jetonin, përrallat që dinin e shumë e shumë histori të bukura. Të dashur fëmijë, nëse i takoni kur të shkoni në plazh, mos harroni të bëheni miq me Arbrin, Silvanën dhe Inën. Por edhe nëse aty do të gjeni fëmijë të tjerë, luani bashkë me ta dhe do ta shikoni se do të kaloni pushimet më të bukura në botë.

Për prindërit dhe edukatorët

Ky tregim mund të ndihmojë fëmijët të kuptojnë sesi krijohen miqësitë. Fëmija ka nevojë të shoqërohet dhe të luajë me fëmijë të tjerë. Përmes qëndrimit në shoqëri, fëmija zhvillon aftësitë sociale. Disa fëmijë kanë më shumë nevojë për kohë për të ndërtuar shoqëritë. Ata kanë nevojë të kuptojnë tjetrin, të ndihen të sigurtë përpara se të fillojnë ndërveprimin. Kjo është shumë normale. Fëmijët, sikundër të rriturit, kanë kohën dhe ritmin personal në ndërtimin e marrëdhënieve.

Fëmijët në moshën parashkollore janë egocentrikë, kanë nevojë për kohë që të mësojnë të ndajnë gjërat e tyre. Duhet ndihmuar dhe udhëhequr në këtë proces, jo të kritikohen apo gjykohen. kanë nevojë të ndihmohen të mësojnë të ndajnë gjërat e tyre me të tjerët. Më tepër se me shpjegim, fëmijët e mësojnë këtë përmes rrëfimeve dhe modeleve.

Pyetje për fëmijët

- Si mendon, pse u mërzit Silvana?
 - Çfarë mendon për sjelljen e Inës? Po për sjelljen e Arbrit?
 - A ke miq (shokë/shoqe)?
- Si vepron ti kur ke dëshirë që të zësh miq të rinj?
 - Çfarë mendon se duhet bërë që të ruash miqësinë me shokët/shoqet?

Tutu mëson të dëgjojë

- Përrallë -

Na ishte njëherë një majmun i vogël që e kishte emrin Tutu. Ai jetonte me mamin, babin dhe vëllain e tij më të madh. Tutu ishte shumë i dashur, por kishte një të metë; e kalonte gjithë ditën duke u hedhur nga një pemë në tjetrën dhe nuk dëgjonte prindërit e tij.

- Tutu, të të tregoj një përrallë? - i tha një ditë mami.

Por, sapo fillonte përralla, Tutu fillonte të hidhej nëpër pemë. Mami lodhej duke e thirrur, por Tutusë i pëlqente shumë të hidhej nga një degë në tjetrën. Kur e panë prindërit se ai filloi të ikte shumë, vendosën që t'i flisnin, sepse kishin frikë mos humbte nëpër xhunglën e madhe.

- Tutu, - i tha një ditë babi, majmunit të vogël. - Më dëgjo të të tregoj diçka për xhunglën. Ty të duket e bukur, por ajo ka shumë rreziqe.

Tutu filloi të hidhej në pemë, por babi e thirri të kthehej. Tutu i mërzhitur u ul pranë babit dhe mamin.

- Tutu, meqë të pëlqen kaq shumë të hidhesh nga një degë në tjetrën, ne do të të tregojmë sesi të gjesh rrugën nëse humbet nëpër xhungël.


- E di rrugën babi. Jam i madh tani, - nxitoi të thoshte Tutu.

- E dimë, por të lutem na dëgjo, se kemi një sekret për të thënë, - i tha mami.

Atëherë Tutu vendosi të ulej dhe të dëgjonte me kujdes prindërit. Por në atë kohë,

kaloi pranë tij një flutur e madhe, me krahët plot ngjyra. Sa i pëlqyen Tutusë krahët e saj!

- Kështu pra Tutu, do të më thuash sesi duhet gjetur rruga kur ke humbur në xhungël?



Tutu heshti. Ai nuk e kishte dëgjuar fare mamin, sepse po shikonte fluturën.

- Më shiko mirë, -i tha babi që menjëherë u hodh në një degë, i bëri një shenjë dhe pastaj u hodh në një degë tjetër dhe i bëri një tjetër shenjë.

Tutu nuk po kuptonte.

- Të thyejmë degët? - pyeti ai me zë të ulët dhe u hodh pranë një dege ku sapo kishte ndaluar flutura e bukur.

Atëherë mami dhe babi u mërzitën shumë, se Tutu nuk po i dëgjonte. Si do t'ia bënte ai që të mos humbte? Si do të mësonte të gjente ushqim dhe të ruhej nga kafshët e egra të xhunglës?

Kur e pa shqetësimin e prindërve të tij, vëllai i madh i Tutusë mendoi t'i ndihmonte.

- Unë di një lojë shumë të bukur, vëllaçko. Ke dëshirë ta mësosh? - tha ai.

- Po, - u përgjigj i gëzuar Tutu, që i pëlqente shumë lojërat.

- Mirë, - i tha vëllai i madh. - Loja është kështu: mami dhe babi do të më thonë mua disa fjalë, pastaj unë do të t'i them ty dhe në fund ti do t'i thuash me zë të lartë. Kush i thotë fjalët pa i ngatërruar, fiton një banane të madhe.

Baba majmuni dhe mami majmunia i thanë fjalët e para në vesh djalit të madh:

Xhungla është e madhe shumë!

Ai i dëgjoji me kujdes. Prindërit majmunë i thanë fjalët e tjera:

Ka plot pemë, por nuk ka rrugë.

Vëllai i madh ndaloi dhe përsëriti me zë të ulët fjalët e reja, pastaj afroi veshin

pranë dy majmunëve që i thanë edhe disa fjalë të tjera.

*Kur të hidhesh degë më degë,
Mos harro të lësh një shenjë,
Që shtëpinë sërish ta gjesh.*



Vëllai dëgjoi me shumë kujdes dhe arriti të mbante mend fjalët, të cilat filloi t'ia thoshte Tutusë.

Xhungla është e madhe shumë!

Tutu përsëriti si vëllai i madh. Kur ai u bë gati të thoshte fjalët e tjera, një zog filloi të këndonte shumë bukur dhe Tutu që e pëlqente këngën e zogjve deshi ta dëgjonte edhe atë zog, por kishte frikë mos e humbte lojën. Ndaj i dëgjoi me kujdes fjalët e vëllait.

Të gjithë po prisnin që Tutu të thoshte fjalët dhe ai ua plotësoi dëshirën.

*Xhungla është e madhe shumë,
Ka plot pemë, por nuk ka rrugë,
Ndaj kur hidhesh degë më degë,
Mos harro të lësh një shenjë,
Që shtëpinë sërish ta gjesh.*

Prindërit majmunë dhe vëllai duartrokitën të gëzuar. Tutu i kishte thënë të gjitha fjalët që kishte dëgjuar më vëmendje. Ai e meritoi me të vërtetë një banane të madhe dhe të verdhë si dielli.

Për prindërit dhe edukatorët

Kjo përrallë mund të ndihmojë fëmijët të kuptojnë pse është e rëndësishme të dëgjosh dhe si ta bëjnë këtë. Fëmijët dëgjojnë atë që u thuhet, por jo gjithmonë e mbajnë mend, ose edhe ku a e mbajnë mend, kurioziteti për të bërë gjëra të reja përfshirja në lojë bëjnë që të harrojnë atë që kanë dëgjuar. Ky proces është delikat. Sepse nuk duhet ndëshkuar për faktin që harron, gjë që u ndodh të gjithëve, por të udhëhiqet që të sigurohemi që e ka dëgjuar dhe mban mend. Sikundër ka nevojë të kujtohet herë pas here për udhëzimet. Fëmijët e kanë të vështirë të arrijnë të kuptojnë se përveç këndvështrimit të tyre për botën dhe ngjarjet, ekzistojnë edhe këndvështrime të tjera. Ata e kanë të vështirë të arrijnë të kuptojnë nevojat dhe dëshirat e fëmijëve të tjerë, apo prindërve. Fëmijët parashkollorë kanë nevojë për mësim në formë konkrete përmes lojës dhe argëtimit. Ndaj, me durim dhe modele personale fëmijët mësojnë të luajnë pa vënë veten në rrezik.

Pyetje për fëmijët

- Çfarë mendon ti për majmunin Tutu? Po për vëllain?
 - Si ndihen prindërit e Tutusë?
 - Çfarë bëri vëllai i Tutusë që ai ta dëgjonte?
- Çfarë mund të ndodhë nëse ne nuk dëgjojmë të tjerët?
 - Si ndihesh ti, kur të tjerët nuk të dëgjojnë?
 - Si e kupton ti nëse të tjerët nuk po të dëgjojnë?
 - Çfarë do të bëje që të tjerët të të dëgjonin?

Pushi dhe babushi

- Përrallë -

Push lepurushit i bëri babi një dhomë të veçantë me një krevat në formën e gjethes së lakrës, një dollap ngjyrë karote, një raft ngjyrë sallate, një mbajtëse televizori bojë banane, lodra të ndryshme dhe me plot videokaseta filmash, që Pushit i pëlqenin shumë.

- Tani je rritur, - i tha babi. - Ke të drejtë të kesh dhomën tënde me çdo gjë që të duhet.

- Ti je babi më i mirë në botë. Edhe ti je mami më e mirë në botë, - u tha prindërve Pushi dhe i puthi aq fort sa nuk i kishte puthur asnjëherë. - Ju dua sa toka...sa deti... sa qielli...saaa...!

- Mjaft, mjaft se u lodhe ! - qeshi babi, pastaj e rrëmbeu në krahë dhe e rrotulloi gjersa iu morën mendtë.

Pushi tërë pasditen e kalonte në dhomën e vet. Shikonte filmat dhe kasetat e linte jashtë raftit, luante me lodrat dhe i hallakaste sa andej këtej, brente karota dhe cungjet i hidhte për tokë... aty flinte dhe krevatin e linte lesh e li.

Ndonjë herë mami e thërriste:

- Push, eja luaj pak me motrën e vogël, se kam punë!

- Edhe unë kam punë, - përgjigjej ai.

Kur babi i thoshte:

- Push, duhet të ujitësh sallatën në kopsht.

- Jam duke parë një film, - ia kthente ai.

Kur mami ankohej:

- Ç'është gjithë kjo rrëmujë në dhomë?

- Po jam akoma i vogël, o'ma! - shfajësohej


i biri.

Një herë, dy herë, tri...

prindërve u erdhi në majë

të hundës. Babi po

priste rastin që t'i



jepte një mësim të mirë. Një ditë Pushi i tha:

- Babi, u mërzita duke i parë ata filmat që kam. Më blej ca të tjerë!

Po babi bëri sikur nuk e dëgjoji. Pushi i lutej ditë për ditë, por babi vetëm heshtte.



- O babi, dua filma të tjerë! Më dëgjon apo nuk më dëgjon?- ngriti zërin Pushi.

- Po ti a dëgjon apo nuk dëgjon kur mami të thotë të rrish pak me motrën dhe të mos bësh aq rrëmujë? Dëgjon apo nuk dëgjon, kur unë të them të ujitësh sallatat e sa e sa gjëra të tjera?...Ti mendon se ke të drejtë të kërkosh çdo gjë. Po, pa më thuaj a ke edhe ndonjë detyrë që duhet ta kryesh?

Pushit iu bënë sytë edhe më të kuq. Lotët i rridhnin përmbi buzët e çara, që i lëvizte pa pushim, pa folur dot asnjë fjalë.

Pas ca kohe, kur prindërit e panë se Pushi i tyre nuk vepronte si më parë, por e kishte kuptuar se kushdo në shtëpi ka detyrat e veta, babi i tha:

- Tani përsëri ke të drejtë të kesh videokaseta të reja.

Dhe ia mbushi raftin plot.

Për prindërit dhe edukatorët

Kjo përrallë mund t'i ndihmojë fëmijët të kuptojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre. Është detyra e prindërve dhe edukatorëve t'i ndihmojnë fëmijët në këtë drejtim. Njohja e të drejtave u shërben fëmijëve që të kuptojnë mënyrat se si mund të realizojnë qëllimet e tyre në jetën e përditshme, si dhe të kuptojnë kufizimet dhe të drejtat që gëzojnë. Dhënia e detyrave të ndryshme në familje dhe kopsht, ndihmon fëmijët që të kuptojnë më mirë detyrat e tyre dhe të jenë më të përgjegjshëm për t'i realizuar në kohë dhe në mënyrën e duhur.

Prindërit shpesh priren të bëjnë gjithçka për fëmijët e tyre. Kjo nuk i ndihmon fëmijët të fitojnë aftësitë e nevojshme për të marrë përgjegjësi dhe për të kuptuar momentet kur mund të marrin përgjegjësi. Fëmijët që mësojnë të mbështeten në përgjegjësitë e tyre, fitojnë respekt për veten dhe mësojnë aftësi për jetën.

Pyetje për fëmijët

- Çfarë mendon ti për Pushin që shihte gjithë ditën televizor?
- Po ti sa kohë sheh televizor?
- Të duket e drejtë që Pushi duhej të ndihmonte prindërit? Pse?
- Ti farë punësh bën në shtëpi?
- Çfarë të pëlqen të bësh për shtëpinë tënde?
- Ti çfarë kupton me fjalën dembel?

Hello, Kitti!

-Tregim -

Xhoisi kishte një mace bukuroshe, me qime të bardha e të ndritura, si dëbora nën rrezet e diellit. E quanin Kitti. Kur u lind Xhoisi, u lind edhe Kitti. Njëra bebushë, tjetra kotele. Rriteshin së bashku, luanin së bashku, flinin gusha gushë, duheshin shumë, ishin shoqe të pandara. Edhe prindërit e saj e donin Kittin, si pjesëtare të familjes. Xhoisit ia festonin ditëlindjen me një tortë të madhe. Kittit, me një tortë të vogël dhe e lejonin të kullufiste një goxha copë. Kaluan kështu pesë vjet. Xhoisi ishte akoma fëmijë, por Kitti tashmë qe bërë një mace e rritur. Megjithatë ato vazhdonin të luanin së bashku.

Një ditë prej ditësh Kitti na u sëmur. Babi e çoi te veterineri, i jepnin ilaçe,



dhe e mjekonin me dhembshuri. Xhoisi kalonte shumë kohë pranë saj, përpiqej ta bënte të lozte. Macja e gjorë e shikonte me ata sytë e vet të gjelbër, që dukej sikur i thoshin:

- E dashura ime, Xhois, ta dish sa kam dëshirë të luaj e të fle me ty, por nuk lëviz dot!

Dhe, vërtet ajo keqësohej përherë e më shumë. Një mëngjes nuk hapte dot as sytë. Babi e vuri në kafazin e saj me shtroje të butë dhe e çoi te veterineri. Kur u kthye



Xhoisi nga kopshti, rendi si përherë te mikesha e vet, por ...vendi ishte bosh.

- Ku është Kitty ? - pyeti.

- E çova te veterineri dhe e lashë atje, që të shërohet, - iu përgjigj babi.

Kaloi një ditë, dy, tri...Vogëlushja, sapo kthehej nga kopshti, vraponte te vendi i Kittit, me shpresë se do ta gjente aty, por sytë i mbusheshin me lot...Një mbrëmje, pasi kishte shkuar të flinte, mami e dëgjoi që po qante dhe hyri në dhomë e shqetësuar.

- Çfarë ke zemra ime e vogël? - e pyeti, duke i fshirë lotët.

- Më ka marrë malli për Kittin.

Mami e përkëdheli gjersa u qetësua, i tregoi një përrallë të bukur dhe e zuri gjumi. Por ajo me babin fjetën vonë atë natë. Ata po mendonin se çfarë duhet të bënin për bijezën e tyre.

Të nesërmen, kur u kthye nga kopshti, te vendi i Kittit, Xhoisi gjeti një kuti të madhe. E hapi me të shpejtë: brenda ishte një mace prej pelushi të bardhë, si qimet e Kittit, me një fjongo ngjyrë trëndafili në kokë dhe me një tjetër në gushë. Në gjoks kishte një varëse, ku shkruhej “ Hello, Kitty!”.

- Ua, sa e bukur! - u lumturua vogëlushja. E ngriti me të dy duart, e përqafoi fort, e puthi dhe i pëshpëriti: - Hello, Kitty, të kam shumë xhan!

Me të në krahë, rendi si flutur në dhomën ku ishin babi e mami. Edhe ata u gëzuan pa masë që çupa e tyre e dashur gjeti një mikeshë të re.

Gjithë pasditen Xhoisi nuk e lëshoi nga dora Hello Kittin. Atë natë e mori në krevat, e përqafoi dhe e zuri gjumi menjëherë. Tani ajo luan, rri e fle me të, ashtu si me Kittin e vërtetë, dhe herë pas here i thotë:

- Kur të shërohet Kitty, do të lozim të tria bashkë.

Për prindërit dhe edukatorët

Kjo përrallë ka për qëllim të njohë fëmijët me konceptin e humbjes dhe të vdekjes si dhe pranimin e tyre si pjesë e jetës. Përmes situatave të përrallave, rrëfimeve, apo ngjarjeve jetësore, fëmijët mund të mësojnë strategji të përballimit të humbjes. Humbjet ndahen në disa kategori, nga sende të vogla, të konsideruara pa shumë vlerë, e deri tek humbja e gjërave më me vlerë, kafshëve shtëpiake dhe personave të dashur në jetë.

Shpesh herë reagimet e fëmijëve ndaj humbjeve reflektojnë reagimet e të rriturve. Nëse prindërit refuzojnë (kanë frikë) të flasin për vdekjen, apo nënvlerësojnë humbjen e një objekti të dashur për fëmijën, fëmija do të mësojë të mohojë dhimbjen personale. Një gjë e tillë krijon probleme emocionale dhe sjellore më vonë, duke qenë se jeta është e mbushur me humbje të të gjitha natyrave. Të rriturit kanë gjithashtu frikë nga ndjenjat e tyre, apo reagimet e fëmijeve. Për këtë arsye, ndodh shpesh që ata të përpiqen të zëvendësojnë shpejt e shpejt objektet e humbura, ose të bëjnë sikur humbja nuk ka ndodhur.

Në momentet që diskutohet humbja, vëmendja ndaj asaj që fëmijët thonë duhet të jetë shumë e madhe. Emocionet e fëmijëve kanë nevojë të kuptohen dhe jo të shpërfillen. Edhe në rastet kur fëmijët tregojnë neglizhencë ose qeshin, duhen parë arsyet që e shpien drejt këtij lloj reagimi. Ndonjëherë ata reagojnë shumë ndryshe nga ç'ndejnë. Për shembull, një fëmijë 5 vjeç, kur iu tha se gjyshi kishte vdekur, ai filloi të qeshte dhe të thoshte se nuk e ndjente shumë. Një reagim i tillë mund të keqkuptohet dhe fëmija të lihet vetëm në dhimbjen e tij.

Pyetje për fëmijët

- Çfarë mendon se i ka ndodhur Kittit?
 - Si do të ndihesh ti në vend të Xhoisit?
 - Ti si ndihesh dhe si vepron, kur të humb diçka që të pëlqen shumë?
- Çfarë mendon ti se ndjen një fëmijë që i vdes macja? Po një njeri i afërt?
 - Çfarë do t'i këshilloje një shoqes/shokut tënd që humb një njeri të afërt?



Save the Children



AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO